



DEPARTAMENTI I SHTETIT TË SHBA



Moore: Shqipëria në NATO, faktor stabiliteti rajonal e më gjerë

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, priti Jonathan Moore

faqe 6

VILNUS 2014/ KONFERENCA

"Dera e Hapur e NATO-s: 10 vjet pas 'Big Bengut'...

faqe 5

GJENERALMAJOR HUSNIAUX

Prezantim mbi të ardhmen e shkencës dhe teknologjisë në NATO

faqe 6

TAKIMI



Gjeneralmajor Bazo takon shefin e shkencës së NATO-s

Në 2015, Bordi i NATO-s në Tiranë

faqe 6

## Kremtohet 5 vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO

# 5 vjet në NATO, Forca e besëlidhjes sonë me Aleancën euro-atlantike

Ministrja Mimi Kodheli: Objektivi ynë madhor, rivitalizimi i Ushtrisë Gjeneralmajor Bazo: Vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit!



faqe 2-4

ZHVILLOHET NË BRUKSEL MINISTERIALI I JASHTËM I NATO-S

Kriza e Ukrainës kryesoi axhendën dy-ditore të bisedimeve së Ministerialit të Jashtëm së NATO-s



faqe 8-9

SHKOLLA E TRUPËS BUNAVI

Një shembull për bashkëpunim e trajnim ndër-institucional

faqe 12

BASHKËPUNIMI ME AMERIKANËT

ANO, zhvillohet "Kursi i Instruktorit të Stërvitjes për Nënoficerë"

faqe 12

LAMTUMIRA NGA KOLEGET

"In Memoriam" për pedagogun e AFA, Neritan Avdulaj

faqe 15

JENS STOLTENBERG



Emërohet Sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s

faqe 9



Ceremonia

# Shqipëria, 5 vjet në NATO

Në sheshin kryesor të Ministrisë së Mbrojtjes, është zhvilluar në datën 31 mars 2014, një ceremoni e veçantë me rastin e 5-vjetorit të pranimit të Shqipërisë në NATO. Në këtë ditë jubilarë ishin të pranishëm: kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ministri i Jashtëm, z. Ditmir Bushati, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, ish-ministra të Mbrojtjes, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarake të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura. Gjithashtu morën pjesë ambasadorë dhe atashe ushtarake të vendeve anëtare të NATO dhe vendeve partnere, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Fjalën e hapjes së ceremonisë së 5-vjetorit të anëtarësimit në NATO e mbajti ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Në fjalën e saj znj. Kodheli tha se, është nder dhe privilegj për mua t'ju drejtohem sot në përvjetorin e 5-të të anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Pesë vite janë një periudhë relativisht e shkurtër për historinë 65-vjeçare të NATO, por pikërisht sot është e rëndësishme të përmend faktin se vendi ynë menjëherë pas ndryshimit të sistemit politik, shprehu vullnetin për t'u rilidhur me botën euroatlantike. Me tej, ministrja Kodheli ka folur për rrugën e gjatë të Shqipërisë drejt anëtarësimit në NATO, duke përmendur pranimin si anëtare e Këshillit për Bashkëpunim të Atlantikut të Veriut në qershor 1992, vizitën në vendin tonë të sekretarit të Përgjithshëm të NATO, Manfred Wörner, përfshirjen në nismën e Partneritetit për Paqe, bashkëpunimin e shkëlqyer me strukturat aleate të NATO gjatë periudhës para anëtarësimit. Me këtë rast ka theksuar ministrja Kodheli, gjej rastin të falënderoj veteranët tanë të misionëve të asaj periudhe në Bosnjë Hercegovinë, Irak, Afganistan, Çad etj. Duke folur për rëndësinë e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ministrja Kodheli u shpreh se "nuk është aspak e vështirë për ne si shqiptarë, që NATO ta cilësojmë si një 'lidhje bese' midis miqsh të nderuar, të vendosur për të mbrojtur njëri-tjetrin, në të drejtën për të jetuar në paqe dhe prosperitet. Ndaj ne jemi të vendosur të mbajmë e lartësojmë rolin tonë si anëtarë të kësaj aleance. Ne do të zbatojmë me vendosmëri reformat e nevojshme për të rivitalizuar ushtrinë dhe institucionet nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim për t'i vendosur ato në standardet e organeve homologe të vendeve aleate në NATO". Sot pas dy dekadash, ka vijuar më tej ministrja Kodheli, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e NATO dhe Forcat tona të Armatosura janë të angazhuara aktivisht në partneritet të ngushtë me aleatët tanë për të siguruar paqen dhe integritetin e vendit, sigurinë e rajonit, të Aleancës, madje duke kontribuar për paqen dhe sigurinë globale. "Kjo datë për vendin tonë, popullin tonë, gjithë bashkëkombësit tanë do të mbetet në ndërgjegje



si ngjarja që na ribashkoi plotësisht me vlerat dhe parimet euroatlantike të lirisë, demokracisë dhe progresit", ka nënvizuar znj. Kodheli. Në përfundim të fjalës së saj ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli shprehu mirënjohjen e saj për mbështetjen e aleatit të madh të Shqipërisë, SHBA, si dhe falënderoi të gjithë aleatët e Shqipërisë në NATO për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre në kuadrin e kësaj ëndrrë të madhe shqiptare. Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, në përshëndetjen e tij theksoi se, po mbushen 5 vjet që historia e Shqipërisë është pasuruar me një ndër datat më të rëndësishme të saj. Anëtarësimi i vendit tonë në NATO, më 1 prill 2009, shënon pa dyshim një ndër ato ngjarje që historia i numëron për rëndësinë e tyre krejt të veçantë. Me këtë rast kryeministri Rama shprehu mirënjohjen për të gjithë ata që punuan për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, duke nënvizuar sidomos mbështetjen e aleatit kryesor, Shteteve të

Bashkuara të Amerikës dhe të gjithë aleatëve dhe partnerëve të tjerë. "Mirënjohje ndaj gjithë atyre që ndihmuan në këtë arritje unike. Mirënjohje popullit shqiptar, Forcave të Armatosura, administratës, shoqërisë civile, radhët e politikës pa dallim, që realizuan reformat, që bënë të mundur anëtarësimin në NATO. Mirënjohja ndaj SHBA është e pashmangshme sa herë që ne do të gëzojmë ditë dhe data si kjo e sotnja, apo do të reflektojnë dhe do të veprojnë për çështje të ekzistencës kombëtare", u shpreh kryeministri Rama. Më tej në fjalën e tij kryeministri Rama u shpreh se prioritet i qeverisë shqiptare mbetet rritja e prestigjit të vendit tonë në NATO, Evropë por edhe në botë. Në mbyllje të ceremonisë, nga Truproja e Nderit e Forcave të Armatosura në nderim të kësaj dite jubilarë u realizuan disa demonstrime, ndërsa në qiellin mbi kuadratet e rreshtuara të FA shqiptare fluturuan helikopterët CUGAR të Forcave Ajrore.

Fjala e Kryeministrit, Edi Rama, në ceremoninë e 5vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO

## 5 vjet në NATO, Forca e besëlidhjes sonë me Aleancën euro-atlantike

Fort të nderuar të pranishëm,  
Të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe  
oficerë, në mënyrë të veçantë,

Po mbushen 5 vjet që historia e Shqipërisë është pasuruar me një ndër datat më të rëndësishme të saj. Anëtarësimi i vendit tonë në NATO, më 1 prill 2009, shënon padyshim një ndër ato ngjarje që historia i numëron për rëndësinë e tyre krejt të veçantë. Përvjetori i pestë i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO është edhe rasti më i mirë, për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj të gjithë atyre që e mundësuan këtë arritje unikalë. E në radhë të parë, mirënjohja u përket të gjithë qytetarëve të këtij vendi, popullit shqiptar, që në harmoni me vokacionin e përhershëm evropian mbështeti në mënyrë plebishitare, projektin e integritetit euroatlantik të vendit, duke u afirmuar kështu, pa asnjë ekuivok, njëri ndër kombet më euroatlantike, ndër ata që dolën nga robëria e perandorisë komuniste, pas rënies së perdes së hekurit. E njëjta mirënjohje u përket padyshim të gjitha kombeve dhe qeverive të vendeve anëtare të NATO-s, që e mbështetën projektin e madh të integritetit të Shqipërisë dhe mundësuan që siguria e Shqipërisë të shndërrohet edhe në një çështje e tyre. E po ashtu, mirënjohjen e respekt të thellë meritojnë



të gjithë ata shqiptarë, ndër Forcat e Armatosura, administratën shtetërore, shoqërinë civile, radhët e politikës pa dallim që realizuan në praktikë reformat e mëdha, të cilat ishin parakusht për anëtarësimin. Pa dashur aspak që të klasifikoj shkalet e mirënjohjes sonë, të qeverisë shqiptare ndaj vendeve dhe

qeverive mike dhe aleate, mendoj se një fjali krejt e veçantë mirënjohjeje ndaj popullit e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e pashmangshme, sa herë që Shqipëria e shqiptarët do të gëzojnë ditë dhe data si kjo, apo do të reflektojnë e do të veprojnë për çështje të ekzistencës së

tyre kombëtare. Natyrisht që mirënjohja jonë ndaj NATO-s nuk kufizohet vetëm tek anëtarësimi. Mirënjohja shqiptare ndaj NATO-s lidhet ngushtë edhe me rolin jetik që kjo aleancë e madhe e lirisë luajti në shuarjen e luftërave të reja në Ballkan dhe posaçërisht, në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Zgjerimi i hapësirave të lirisë në lindje të Evropës, pushimi i luftës, vendosja e paqes në Ballkan dhe liria e Kosovës mbeten një kontribut i pashlyeshëm i Aleancës, pas përballimit me sukses të plotë të Luftës së Ftohtë. Duke bashkuar sigurinë tonë me atë të 27 vendeve të tjera të Aleancës së Atlantikut të Veriut, ne shqiptarët, kemi realizuar investimin më të madh për sigurinë tonë kombëtare. Me nënshkrimin e Traktatit të Uashingtonit, vendi ynë është bërë pjesë e aleancës më të fuqishme dhe padyshim më të pathyeshme në historinë e njerëzimit. Garancia për sigurinë tonë kombëtare ka mbërritur kështu, në nivelet më të larta të mundshme, të paimagjinueshme, vetëm pak kohë më parë, në të gjallët e të gjithëve në këtu. Duke u integruar në aleancën e madhe, Shqipëria është bërë njëkohësisht, edhe pjesë e pandashme e përmbytjes dhe e shprehjes së botës së lirë. Botës së vlerave të larta të demokracisë, lirisë dhe të drejtave njerëzore, ekonomisë së lirë dhe shtetit ligjor. Anëtarësimi në NATO e ka rritur si kurrë më parë, rëndësinë dhe fuqinë politike të Shqipërisë si shtet, i cili tashmë është pjesë aktive e vendimmarrjeve më të rëndësishme për sigurinë, në rrafshin global. Të gjitha përparësitë e jashtëzakonshme

STAFI

Kryeredaktor:  
Albert HITOALIAJGazetarë:  
Alba MUSARAJRedaktore korrektore:  
Elona SHIMAJ MAKOGraphic Designer:  
Afërdita HYSAJADRESA:  
Ministria e Mbrojtjes,  
Rruga e Dibrës,  
"Garnizoni Skënderbej"© Ministria e Mbrojtjes  
Materialet e publikuara në këtë gazetë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfuturi, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Qëndrimet, pikëshikimet dhe opinionet e shprehura në gazetën "USHTRIA" i përkasin plotësisht autorëve të shkrimeve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrime apo pozicionime zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe SHPPA.



Fjala e ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, me rastin e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO

# "Objektivi ynë madhor: rivitalizimi i Ushtrisë"

Është nder dhe privilegj për mua t'ju drejtohem sot në përvjetorin e 5 të anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Pesë vite janë një periudhë relativisht e shkurtër për historinë 65-vjeçare të NATO, por pikërisht sot është e rëndësishme të përmend faktin se vendi ynë menjëherë pas ndryshimit të sistemit politik, shprehu vullnetin për t'u rilidhur me botën euroatlantike. Kështu në qershor të vitit 1992, Shqipëria u pranua si anëtare e Këshillit për Bashkëpunim të Atlantikut të Veriut, një mekanizëm ky i NATO për të zgjeruar bashkëpunimin edhe me vendet që pak kohë më parë gjendeshin të rreshtuara kundër Aleancës. Vetëm një vit më vonë vendin tone do ta vizitonte Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Manfred Wörner, i cili do të deklaronte në Kuvend se NATO do ta mbështesë Shqipërinë me qëllim modernizimin e FA, të cilat do të aftësoheshin jo vetëm për të siguruar vendin, por edhe për të garantuar sigurinë Euroatlantike së bashku me forcat NATO. Pas angazhimit politiko-strategjik në Këshillin e Bashkëpunimit të NATO, Shqipëria u bë pjesë edhe e një nisme tjetër që e angazhonte atë edhe në planin politiko-ushtarak, Partneriteti për Paqe. Shumë prej nesh kujtojnë angazhimet e para, sado modeste, të forcave tona jashtë vendit, pikërisht nën ombrellën e kësaj nisme. Ndërkaq, bashkëpunimi i shkëlqyer midis qeverisë dhe shoqërisë shqiptare me strukturat aleate të NATO, mundësoi përballimin me sukses të krizës humanitare përgjatë luftës së Kosovës në vitin 1999. Angazhimi i NATO në zgjidhjen përfundimtare të atij konflikti përveçse na bën të jemi mirënjohës përjetësisht, na bën në mënyrë të veçantë krenarë për qenien pjesë e kësaj organizate. Më tej, duke vijuar me eksperiencat ushtarake



si partner të NATO ne mund të rikujtojmë edhe eksperiencat domethënëse të periudhës së para-anëtarësimit. Gjej rastin të falënderoj veteranët tanë të misioneve të asaj periudhe në Bosnjë Hercegovinë, Irak, Afganistan, Çad etj. Eksperiencat e atij procesi, sidomos që nga nënshkrimi i Planit të Veprimit për Anëtarësim në vitin 1999, ka ndikuar shumë në transformimin e sektorit të sigurisë së vendit tonë. Dhe ja ku jemi sot pas dy dekadash, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e NATO dhe Forcat tona të Armatosura të angazhuara aktivisht në partneritet të ngushtë me aleatët tanë për ta siguruar paqen dhe integritetin e vendit, sigurinë e rajonit, të Aleancës, madje duke kontribuar edhe për paqen e sigurinë globale. Përfitoj nga rasti

për t'i përshëndetur ushtarakët tanë në misionet jashtë vendit, të cilët, janë simboli më i qartë i anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë.

Përkujtimi i ditës së anëtarësimit të vendit tonë në NATO është një veprimtari simbolike, por ama festimi i kësaj dite nuk ka vetëm vlerë kronografike. Kjo datë për vendin tonë, popullin tonë, gjithë bashkëkombësit tanë do të mbetet në ndërgjegje si ngjarja që na ribashkoi plotësisht me vlerat dhe parimet euroatlantike të lirisë, demokracisë dhe progresit. Nuk është aspak e vështirë për ne si shqiptarë, që NATO ta cilësojmë si një "lidhje bese" midis miqsh të nderuar, të vendosur për të mbrojtur njëri-tjetrin, në të drejtën për të jetuar në paqe dhe prosperitet. Ndaj ne jemi të vendosur të mbajmë e lartësojmë rolin tonë si anëtarë

të kësaj Aleance. Ne do të zbatojmë me vendosmëri reformat e nevojshme për të rivitalizuar ushtrinë dhe institucionet nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim për t'i vendosur ato në standardet e organeve homologe të vendeve aleate në NATO. Qasja jonë për të arritur këtë objektivi madhor është dy planëshe. Së pari, ne synojmë të bëjmë rregullime ligjore përkatëse, duke filluar nga dokumentet strategjike kombëtare e ushtarakë për të garantuar një bazë ligjore të shëndoshë e të përditësuar. Së dyti, qëllimi ynë është të realizojmë sa më shpejt ristrukturimin e të gjithë dispozitivit të FA, për ta bërë atë më të zhdërvjellët dhe më të ndërveprueshme në detyrat e brendshme dhe ato të jashtme, sipas nevojës. Ministria e Mbrojtjes, qeveria Shqiptare janë të

fokusuara tek reforma, sidomos ato që lidhen me përmirësimin e sistemit arsimor të ushtarakëve, modernizimin e bazës materiale, sistemin e stërvitjes dhe rigjallërimin e projekteve për të cilat jemi dakordësuar me Aleancën prej disa vitesh, por që pak është bërë. Kemi akoma shumë punë për të bërë për të ngritur FA në një pozicion të respektueshëm brenda Aleancës. Por ne jemi të vendosur t'ju rikthejmë dinjitetin e munguar FA, jo vetëm duke ju krijuar kushtet për të kryer sa më mirë detyrat e tyre, por edhe duke eliminuar praktikën korruptive dhe zhvlerësuese të punës së tyre. Jemi të vendosur po ashtu: të mbështesim Aleancën në çdo angazhim ku ajo thirret të veprojë, të ofrojmë kontributet tona në interesin e përbashkët për një botë më të paqte e më të begatë përkrah aleatit tonë strategjik, SHBA; të kryejmë sa më parë detyrimet në kuadër të anëtarësimit në BE; të vijojmë bashkëpunimin me organizatat e tjera rajonale që adresojnë çështje të sigurisë, me qëllim promovimin e paqes në rajon e më gjerë, si dhe anëtarësimin e vendeve të rajonit në strukturat euroatlantike. Në mbyllje do të doja të shprehja mirënjohjen për mbështetjen e aleatit të madh të Shqipërisë, SHBA. Falënderime të ngrohta shkojnë dhe për të gjithë aleatët tanë në NATO, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre në kuadrin e kësaj ëndrre të madhe shqiptare. Falënderime të sinqerta u shkojnë dhe ushtarakëve shqiptarë e punonjësve të ministrisë ndër vite, të cilët kanë shërbyer me përkushtim. Së fundi do të doja t'i përcillja urimet më të mira vetë NATO, e cila feston 68-vjetorin e krijimit të saj, pa harruar bashkudhëtarët tanë kroatë për 5-vjetorin e anëtarësimit. Një urim i veçantë shkon edhe për vendet e tjera të rajonit, të cilat presin ti bashkohen Aleancës.

*Gëzuar të gjithëve!*

që shoqërojnë praninë tonë në NATO janë në të njëjtën kohë, pa më të voglin dyshim, edhe përgjegjësi po aq madhore për secilin ndër ne. Në radhë të parë, me hyrjen në NATO, Shqipëria ka jo vetëm garantuar angazhimin e saj, por ka garantuar edhe angazhimin e gjithë aleatëve të saj për të mbrojtur edhe ushtarakisht integritetin dhe pavarësinë e saj. Dhe, nga ana tjetër, Shqipëria është angazhuar ligjërisht për të kontribuar në të njëjtën mënyrë, edhe për mbrojtjen e integritetit dhe të pavarësisë të çdo vendi, aleat me të. Ashtu sikundër, edhe për mbrojtjen e paqes, lirive dhe të drejtave kudo ku kjo aleancë e shpreh eventalisht të bëhet e nevojshme. Përgjegjësia për të mbajtur edhe barrën e të tjerëve përbën padyshim një ndër arsyet për të qenë sot, krenarë për Shqipërinë, por dhe një ndër detyrimet më të jashtëzakonshme për nga serioziteti, të vendit tonë në historinë e tij. Po ashtu, mbajtja e barrës përkatëse në të gjithë spektrin e angazhimeve operacionale të NATO-s kudo në botë, është sot pjesë integrale e detyrimeve të vendit dhe e detyrimeve tona ndaj vetë vendit. Mund të pohohet me krenari, në këtë pesë vjetor kaq të shënuar, se Shqipëria e ka plotësuar dhe vazhdon ta plotësojë me përgjegjësi të plotë dhe me sukses, çdo pjesë të përgjegjësisë së saj në

gjirin e kësaj Aleance të madhe. Por përgjegjësitë e vendit, në kuadër të Aleancës nuk janë thjesht dhe vetëm ushtarake. Dhe këtë, çdo shqiptar, secili ndër ju, të nderuar ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, por në radhën më të parë, secili ndër përfaqësuesit e popullit shqiptar, pa dallim, qeveria në radhë të parë nuk duhet në asnjë mënyrë ta harrojë. Sepse në radhë të parë, Shqipërisë i kërkohet të përmbushë me dinjitet, aspirata e pritshmëri në rrafshin politik nëpërmjet realizimit standardeve më të larta të demokracisë e shtetit ligjor dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Janë këto standarde dhe respekti për parimësinë dhe për vlerat e demokracisë, që është në themelin e kësaj Aleance të madhe ushtarake. Angazhimi ynë për ti përmirësuar më tej këto standarde, në mënyrë të vazhdueshme, këmbëngulëse dhe të pandalshme dhe për ti dhënë vendit tonë prestigjin më të lartë në Evropë dhe në botë, duke i dhënë po ashtu edhe seriozitetin më të lartë në tryezën e vendimmarrjes të madhe të NATO-s, mbetet gjithnjë prioritar. Jetojmë në një botë që provon çdo ditë se sa largpamëse ka qenë ideja për ti dhënë jetë kësaj Aleance dhe sesa aktuale është çdo përpjekje për ta forcuar dita-ditës këtë Aleancë. Zhvillimet e fundit në Ukrainë, ndër të tjera, shërbyen edhe njëherë tjetër

për ta sjellë para syve tanë, rëndësinë e jashtëzakonshme të vlerave dhe parimeve të botës, së cilës i kemi dhënë përkatësinë dhe padyshim çështjen e sigurisë, si një çështje që është çdo ditë në rëndin e ditës, sado e sigurt që të duket bota nga hapësira ku ne jetojmë dhe nga këndi prej ku ne e shohim. Turbullirat e rrezikshme në një vend si Ukraina, shpëputja prej andej e Gadishullit të Krimesë nga Rusia, ndryshimi arbitrar i kufijve shtetëror, - ilustrojnë në mënyrë brutale, domethënëse e madhe të përpjekjes për siguri dhe nga ana tjetër të mungesës së sigurisë nëpër botë. Ukraina është një tjetër provë, më e freskëta e për këtë dhe më e dhimbshmeja e ditëve tona që tregon se, siguria nuk mundet dhe nuk duhet të zbrësë kurrë më poshtë, nga kreu i prioriteteve të botës sonë, të botës së kësaj Aleance të madhe dhe padyshim të një shteti që është pjesë e kësaj Aleance, siç është dhe Shqipëria e vogël. E ndërgjegjshme për këtë, qeveria e Shqipërisë, krahas inovacionit dhe progresit të vazhdueshëm e ka sigurinë, moton qendrore të përpjekjes saj për të ecur më shpejt drejt rilindjes, në interes të garantimit të sigurisë në të gjitha përmasat e saj, nga siguria më e vogël por po kaq e rëndësishme e të përditshmes të çdo individi në raport me shtetin e vet këtu në Shqipëri, tek siguria më e

madhe, por po aq e rëndësishme në cilësinë e vet, e shtetit tonë krahas për krahas me të gjitha shtetet e Aleancës ku jemi pjesë, ne po punojmë për realizimin e një programi të tërë transformimi rrënjësor të instrumenteve të sigurisë kombëtare. Hartimi i dokumentit të parë të strategjisë së sigurisë kombëtare, pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO; reforma e thellë ligjore dhe strukturore e institucioneve të sigurisë; modernizimi i vazhdueshëm i forcave të armatosura, policisë së shtetit, shërbimeve inteligjente dhe strukturave të tjera ligjzbatuese janë sot, prioritete të dorës së parë dhe janë sot në rëndin e ditës së punës sonë me mish e me shpirt, si qeveri e Shqipërisë për një Shqipëri evropiane, për një Shqipëri serioze dhe gjithnjë të përgjegjshme në tryezën e madhe të vendimmarrjes së Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Javën që shkoi Presidenti Barack Obama tha: "Situata në Ukrainë na kujton se "Liria nuk është falas" "Freedom is not free", -kjo thirrje lakonike ndeshet shpesh gjatë historisë në fjalime e po ashtu në refrene këngësh. Ajo duket se kërkon të na kujtojë se të gjithë ne, duhet të jemi të gatshëm të paguajmë çmimin e lirisë sonë në çdo përmasë dhe nga çdo kënd. Lirinë, askush, asnjë individ, asnjë komunitet, asnjë popull dhe padyshim edhe një Aleancë

e madhe si kjo, nuk mund ta ketë falas. Përvjetori i 5-të i anëtarësimit të vendit tonë në NATO, na kujton gjithashtu se për fatin tonë më të madh, ne tashmë e kemi bashkuar të ardhmen me popuj të lirë, me popuj të mëdhenj, me popuj që çmimin e lirisë e kanë paguar dhe e paguajnë pa as më të voglin ngurrim, si çmimin e mirëqenies dhe të sigurisë për të sotmen dhe për gjeneratat që vijnë. Pjesëmarrja në këtë Aleancë e bën barrën tonë shumë më të lehtë, sigurinë tonë shumë më të lartë, çmimin e lirisë sonë shumë më të merituar. Por megjithatë liria nuk mund të jetë falas. E në këtë përvjetor të anëtarësimit tonë në NATO, gjaku i dëshmorit tonë, kapiten Feti Voglit dhe gjaku i shumë djemve dhe vajzave ushtarakë dhe ushtarake, në gjirin e forcave aleate, në frontet ku kjo Aleancë lufton për lirinë dhe sigurinë, janë dëshmia më kuptimplotë e çmimit të lirisë, por janë dhe prova më e padiskutueshme e forcës së besëlidhjes sonë të madhe euroatlantike. Faleminderit të gjithëve! Gëzuar 5 vjetorin e pjesëmarrjes në NATO, në Aleancën e madhe euroatlantike të popujve të lirë, të popujve që çdo ditë paguajnë çmimin e lirisë se tyre, për mirëqenien e tyre dhe për sigurinë e gjeneratave të tjera dhe të botës ku jetojmë.

*Edhe një herë faleminderit dhe gëzuar!*



Përshëndetje e SHSHPFARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo, me rastin e 5-vjetorit të anëtarësimit në NATO

# "Nuk duhet të harrojmë se vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit!"

*Të dashur pjesëtarë të Forcave të Armatosura,*

Ndjem i nderuar, njëkohësisht edhe i privilegjuar, që kam mundësinë t'ju adresohem juve, në këtë eveniment të rëndësishëm. Pesë vite më parë, kjo u quajt një ngjarje historike, ngjarje që shënoi anëtarësimin e me të drejta të plota të Shqipërisë në NATO. Termi "historik" përdoret shpesh në ditët e sotme, por duke u nisur nga rëndësia e periudhave transformuese që ka kaluar apo po kalon vendi ynë, vështirë të mund të shmangesh nga këto ngjyrime hiperbolike. NATO është koalicioni më i suksesshëm në histori, i bazuar në ndarjen e vlerave demokratike dhe një angazhimi të të gjithëve, për një siguri të paprekshme. Kjo ngjarje, ishte preludi i përpjekjeve tona politiko-historike, që filluan me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri, vendosjen e demokracisë, shprehjen e vullnetit politik për t'iu bashkuar kësaj Aleance, dhe pjesëmarrjen aktive në organizmat dhe programet që i paraprinin anëtarësimit. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, zgjidhi një prej problemeve kryesore që na ka shoqëruar këto 101 vite si shtet i pavarur, problemin e sigurisë. Shqipëria sot është më e sigurt, kjo në këndvështrimin e mbrojtjes kombëtare. Shpesh dëgjohen edhe zërat skeptikë, që vënë në dyshim vlerën e NATO-s. Por ne jemi mëse të qartë se vlera e NATO-s nuk matet në terma financiarë. Sepse, siguria jonë është e pamatshme. Mbrojtja e lirisë kurrë nuk mund të vijë pa shpenzime dhe është kyçe që edhe Shqipëria të qëndrojë së bashku me vendet e tjera në mbrojtjen e vlerave të përbashkëta-lirisë së kombeve, demokracisë dhe mbizotërimit të ligjit. Anëtarësimi në NATO shënoi fillimin e një procesi po kaq të rëndësishëm, procesin e integritetit të plotë, që çdo vend i sapo-anëtarësuar duhet të kryejë.



Ky proces, përfshiu transformimin e Forcave tona të Armatosura në fushat doktrinare, organizative, stërvitore/trajnuese, pajisjeve, personelit dhe burimeve, duke i bërë ato më të ndërveprueshme me simotrat e tyre në Aleancë. Procesi u udhëhoq dhe monitorua nga Komanda e Aleancës për Transformim (ACT) dhe përfundoi me certifikimin e integritetit të plotë në tetor të vitit 2013. Ne jemi krejt të vetëdijshëm që ky proces, nuk përfundon me kaq. Si vetë Aleanca, që për emër "mesi" apo "atësie" ka "transformimin", edhe Forcat tona të Armatosura, si një organizëm vital, janë gjithmonë në një proces të vazhdueshëm transformimi dhe evolucioni. Ky transformim kryhet për t'iu përshtatur sa më mirë kushteve në të cilat FA operojnë, për të ndërtuar ka-

pacitetet e duhura me qëllim realizimin e misionit dhe detyrave të ngarkuara, por edhe detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO sepse një Aleancë e suksesshme mund të triumfojë vetëm nëpërmjet vëmendjes dhe kontributit të vazhdueshëm të vendeve anëtare.

Sikundër Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Rasmussen, është shprehur: "Ne jemi shumë të ndërgjegjshëm për ndarjen jo të drejtë të peshës brenda Aleancës, që po ushtron një ndikim të madh në lidhjet trans-atlantike. Riformimi i lidhjeve transatlantike është një përgjegjësi e përbashkët që kërkon hapa kuptimplotë, praktikë dhe urgjentë. Evropa duhet të bëjë më shumë për ofrimin e kapaciteteve mbrojtëse" ne jemi duke marrë të gjitha masat e duhura si në aspektin

planëzues por edhe në atë organizativ, për të përmbushur me sukses detyrimet e paketës së Objektivave të Kapaciteteve, pranuar qershorin e kaluar, me fokusin kryesor, krijimin, organizimin, trajnimin dhe vënien në dispozicion të Aleancës së një batalioni këmbësorie të motorizuar. Për realizimin me sukses të këtij objektiv, fokusi i modernizimit do të drejtohet për pajisjen me armatim dhe pajime luftarake individuale sipas standardeve të NATO-s, të personelit të këtij batalioni.

Njëkohësisht, si shprehje e vullnetit për përmbushje sa më të mirë të detyrimeve ndaj kësaj Aleance, Shqipëria ka vijuar pjesëmarrjen me sukses në operacionet e NATO-s, si në operacionin ISAF në Afganistan me ekupe OMLT/MAT, të forcave speciale etj, si dhe

në operacionin KFOR në Kosovë me personel në shtab. Po ashtu, Shqipëria është e gatshme për të vijuar kontributin e saj edhe pas përfundimit të operacionit ISAF dhe fillimit të misionit "Resolute Support".

Në këto 5 vite anëtarësim, Forcat e Armatosura kanë pasur edhe arritje të tjera të rëndësishme. Këtu mund të përmendet, procesi i demontimit të municioneve dhe armatimit të tepërt, njohja dhe përdorimi i Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s duke e përfunduar Planifikimin Kombëtar me atë, si dhe automatizimi i sistemit të menaxhimit të personelit dhe materialeve. Por ndërkohë ka filluar dhe vijon puna për reformën legjislativë, nëpërmjet të cilës do të rregullohet më mirë veprimtaria e FA.

Ne nuk duhet të harrojmë se vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit - burrat e gratë kurajoze, të palodhur në nivelet dhe gradat e ndryshme në radhët e Forcave të Armatosura. Ata mishërojnë vlerat tona dhe shembuj për tu ndjekur nga shoqëria e më gjerë. Ne, lidhshipi civilo-ushtarak, ju detyrohemi angazhimin tonë për një mbështetje sa më dinjitoze, me qëllim vlerësimin e vlerave që ju mishëroni dhe kryerjen e detyrave kushtetuese.

Një falënderim i veçantë u takon partnerëve dhe aleatëve tanë në NATO dhe strukturave të saj organizative, të cilat na kanë mbështetur dhe vijojnë t'a bëjnë atë, në rrugën tonë bashkëpunimit. Në përfundim dua të shpreh bindjen time të plotë dhe njëkohësisht garantoj që Forcat e Armatosura të RSH, do të jenë gjithmonë anëtare të denja të NATO-s duke përmbushur me sukses sfidat dhe përballjet që ato kanë përpara dhe duke qenë në lartësinë e detyrave që i ngarkon misioni i tyre kushtetues.

*Ju faleminderit!*





Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, merr pjesë në konferencën “Dera e Hapur e NATO-s: 10 vjet pas ‘Big Bengut’”, Vilnius 2014, Lituani

# NATO, 10 vjet pas ‘Big Bengut’...

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ndodhet për një vizitë zyrtare në Lituani në kuadër të konferencës me “Dera e Hapur e NATO-s: 10 vjet pas ‘Big Bengut’” (NATO Open Door: Ten Years after the ‘Big Bang’), që po zhvillohet në Vilnius, të Lituani në datat 3 dhe 4 prill. Kjo konferencë shihet të mbledhur bashkë, përfaqësues nga vendet Baltike, vendet e Kartës së Adriatikut (A-5), zyrtarë të NATO-s e të ftuar të tjerë. Konferenca është e organizuar nga “Qendra e Ekselencës së NATO-s për Sigurinë Energjetike” (NATO Energy Security Centre of Excellence), ministria lituaneze e Jashtme dhe e Mbrojtjes, universiteti Vytautas Magnus dhe “Qendra për Studime Gjeopolitike” (Centre for Geopolitical Studies). Në këtë konferencë marrin pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe ministrat e Punëve të Jashtme të: Belgjikës, Gjeorgjisë, Sllovenisë, vendeve Baltike, vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut (A-5), vende vëzhguese etj. Në ditën e parë të kësaj konference të gjithë ministrat e Mbrojtjes dhe ministrat e Punëve të Jashtme pjesëmarrës diskutuan në lidhje me Politikën e Dyerve të Hapura të NATO-s, ndërsa në ditën e dytë të konferencës, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli do të zhvillojë një takim me ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Lituani z. Jouzas Olekas. Çështjet që do të trajtohen në këtë takim do të jenë: çështjet e NATO-s, situata e Sigurisë në Europë si dhe operacionet ndërkombehtarë.

Viti 2004, kur shtatë shtete u bënë pjesë e komuniteteve të Europës Perëndimore dhe të atij Euro-Atlantik, shënon pikën e kthimit në rajonin euro-atlantik, që pas shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik. Në të njëjtën kohë, ndodhën ndryshime të rëndësishme në politikën e brendshme të fqinjëve të Aleancës (Ukrainë dhe Gjeorgji), të cilat ka shpënë drejt kërcënimeve me fokus asimetrik e natyrë hibride, siç është ndërprerja e rrugëve furnizuese, krizat financiare dhe ekonomike (shkaku kryesor i shkurtimit të shpenzimeve të Mbrojtjes), sfidat e migrimeve, kërcënimet kibernetike, etj. Si pasojë e këtyre, NATO filloi e në disa raste edhe i përfundoi, misionet të cilat kanë përcaktuar drejtimin e zhvillimit të Aleancës për më shumë se një dekadë. Thuajse çdo gjë, - strukturë, kapacitete, ndërthurje operacionesh, marrëdhënie me partnerët - ka ndryshuar gjatë dekadës së fundit. Vendet e Europës Juglindore (përfshirë këtu edhe shtetet baltike), patën mundësinë që të udhëheqin procese të rëndësishëm brenda Aleancës. Krijimi i qendrave të ekselencës, pjesëmarrja aktive në operacionet e NATO-s, bashkëpunimi për konceptin e ri të Sigurisë, shkëmbimi i eksperiencës së anëtarësimit në NATO me partnerët e afërt dhe anëtarët e ardhshëm në Jug e në Lindje, janë veç pak shembuj, që mund të përmenden në këtë drejtim. Sot ka ardhur momenti për të vlerësuar ndryshimet në Aleancë dhe në rajonin e Europës Juglindore, të vlerësohet situata e sigurisë në rajon, kontributi rajonal ndaj NATO-s, ashtu si dhe interesat e aspiratat e NATO-s. Kjo konferencë që përkon me 10-vjetorin e anëtarësimit të vendeve Baltike në NATO, është një moment perfekt për të realizuar këto që përmendëm.

“Unë do të thosha se zgjerimi i NATO-s, ka qenë gjithashtu i mirë edhe për Rusinë. Dhe do të doja të shfrytëzoja këtë rast, për të refuzuar



## “Integrimi në Aleancë i vendeve të Ballkanit, është vazhdimësia jonë”

*Fjala e ministres Kodheli në konferencën e Vilnosit*

Shumë gjëra kanë ndryshuar 10 vjet pas rritjes më të madhe të anëtarësisë së NATO. Shqiptarët dhe kroatët i janë bashkuar Aleancës. Tashmë jemi një grup prej 28 vendesh me një dëshirë të palëkundur për paqe, stabilitet dhe siguri kudo në botë. Natyra e konflikteve që NATO ka përballuar në këtë dekadë ka qenë e shumëllajshme dhe me shtrirje të gjerë gjeografike, por duket se gjithçka po shkon drejt konflikteve nacionaliste, me një kthim tek diferencat midis Lindjes dhe Perëndimit. Pikërisht në kufijtë e Aleancës sonë, ne përballlemi me dy konflikte të mëdha. Aneksimi i Krimesë nga Rusia është një shqetësim i madh për të gjithë aleatët. Të gjithë i njohim dimensionet dhe pikëpamjet e perandorisë sovjetike, me të gjitha implikimet e saj. Por kjo nuk është vetëm një krizë rajonale, por implikon çdokënd në këtë sallë dhe më gjerë. Ndërkohë, Siria ka sjellë pranë kufijve tanë atë çka ne e kemi luftuar në Afganistan dhe Irak. Një shtet viran në mes të një lufte civile, me shumë implikime për shkak të përfshirjes së grupeve radikale. Ne jetojmë në një botë re-



alisht mizore dhe këtë nuk duhet ta harrojmë. Shumë gjëra po ndodhin, shumë përfshirje dhe nevojë për veprim. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për vullnetin e palëkundur për të forcuar mbrojtjen tonë kolektive dhe lidhjen tonë transatlantike. Dhe meqë NATO është më shumë se një Aleancë ushtarake, duhet të shikojmë edhe nga oborri i shtëpisë sonë. Ekziston në Europë një rajon i shkatërruar nga konfliktet nacionaliste gjatë dekadës së fundit të

shekullit të XX. Bosnje dhe Hercegovina, Serbia, Kosova, së bashku me Maqedoninë dhe Malin e Zi nuk janë bërë ende pjesë e Aleancës. Të pesta këto vende ndjekin rrugëtimin e tyre specifik drejt Aleancës, me vullnet dhe axhendë të ndryshme; prej tyre, kemi vende ekzistenca e të cilëve është siguruar nga përfshirja direkt e NATO, por që ende janë të brishtë në ndërtimin e demokracive të tyre, por kemi edhe kandidatë të fortë që

duhet të bëheshin pjesë e Aleancës qysh në vitin 2009. Për t'i bërë gjërat edhe më shqetësuese, kjo zonë e kontinentit tonë nuk është e integruar as në BE. Aleatët e NATO-s dhe partnerët europianë kanë dyshimet e tyre, kushtëzimet e tyre ekonomike, axhendat politike dhe shqetësimet sociale për ta. Por në këtë periudhë të rikthimit të konflikteve nacionaliste, mendoj që integrimi është i vetmi mjet për të parandaluar konflikte të tjera. Duke integruar në komunitetin e Aleancës vendet e Ballkanit të cilat janë akoma jashtë saj, unë besoj fort që Aleanca do të bëhet një grup më i madh vendesh që ndajnë të njëjtat vlera për mbrojtjen kolektive. Kjo zonë është vazhdimësia jonë. Ne ndajmë të njëjtat vlera europiane dhe kemi të njëjtat qëllime për të ardhmen. Nëse do të ketë më shumë vullnet politik, e përsëris, vetëm me shumë vullnet politik, nuk do të eksportohen më konflikte nga Lindja. Kështu do të jemi më të fokusuar në kufijtë e Aleancës dhe do të jemi të aftë të pengojmë preokupimet që vijnë prej saj, kërcënimi parësor i kësaj Aleance.

*Faleminderit!*

argumentin që ka ndonjëri në Rusi apo tjetërkund, që e ka parë këtë politikë zgjerimi të NATO-s si të skicuar për të dobësuar Rusinë, për ta “rrethuar” atë e se kjo politikë luajti një rol të pjesshëm në shtyrjen e Rusisë drejt aneksimit efektiv të pjesëve të Gjeorgjisë gjashtë vjet më parë dhe të Krimesë muajin e shkuar. Për më tepër, në vend që ta kërcënojë Rusinë, zgjerimi NATO-s – bashkë me zgjerimin e Bashkimit

European – ka shpërndarë stabilitet, demokraci dhe sundim të ligjit në gjithë Europën. Kufijtë perëndimorë të Rusisë, nuk kanë qenë kurrë më parë më të sigurt dhe hapësira të mëdha të Europës Qendrore dhe Lindore kanë parë një zhvillim të pakrahueshëm ekonomik dhe tregti e investim pa kufij, prej të cilave ka fituar edhe Rusia. Është për të ardhur keq që ky progres është i vënë në rrezik tani, nga gatishmëria e Rusisë

për të përdorur forcën, për rikësimin e kufijve dhe krijimin e kufijve të rinj. Përballë kësaj sfide, tashmë është më e rëndësishme se kurrë më ndonjëherë, që të mbështesim parimin se çdo komb është i lirë që të zgjedhë fatin e tij. Ne duhet të rrimë shtrënguar pas vizionit tonë të një Europe të plotë, të lirë e në paqe. Dhe ne duhet që të mbajmë hapur derën e NATO-s për të ndihmuar që ky vizion të bëhet një realitet. Samiti i ardhshëm

i NATO-s, në shtator, në Wells, do të jetë një mundësi e mirë që të demonstrojmë këtë vendosmëri”- tha ndër të tjera në fjalimin e tij në këtë konferencë, zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Ambasador Alexander Vershbow, duke dhënë në këtë mënyrë edhe mesazhin e thelbësor të Aleancës, i cili po të përmbledhej në një pak fjalë do të ishte: Zgjerimi i NATO-s prodhon më shumë siguri për të gjithë.



Ministrja e Mbrojtjes Kodheli priti Jonathan Moore

# Moore: Shqipëria në NATO, faktor stabiliteti rajonal e më gjerë



**M**inistrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, paraditen datës 1 prill 2014, ka pritur në një takim të veçantë z. Jonathan Moore, drejtorin e Zyrës për Çështjet e Evropës Qendrore e Jugore në Departamentin e Shtetit, SHBA. Gjatë këtij takimi z. Moore shoqërohej nga ambasadori i SHBA në Tiranë, z. Alexander Arvizu. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli ka falënderuar z. Jonathan Moore për vizitën dhe i ka shprehur atij mirënjohje të thellë për kontributin që SHBA ka dhënë në

ndihmë të shqiptarëve dhe Shqipërisë sidomos në procesin e integritetit të vendit në strukturën euroatlantike. Znj. Kodheli e ka njohur z. Moore me reformën në Forcat e Armatosura duke nënvizuar vullnetin e plotë të saj dhe të mazhorancës për t'i kthyer ushtrisë shqiptare dinjitetin e merituar. Z. Moore uroi popullin shqiptar për përvjetorin e anëtarësimit në NATO duke nënvizuar se angazhimi i Shqipërisë në Aleancë është faktor stabiliteti në rajon e me gjerë. Ai vazhdoi më tej duke thënë se vlerëson pjesëmarrjen e Shqipërisë në misionet

paqeruajtëse nën flamurin e NATO-s. Moore përsëriti sërish mbështetjen e SHBA në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Reformat e qeverisë shqiptare dhe sidomos të Ministrisë së Mbrojtjes ishin në qendër të kësaj bisede. Ai vlerësoi punën e bërë deri në këto momente dhe e inkurajoi ministren Kodheli për vazhdimin e mëtejshëm të këtyre reformave. Ministrja Kodheli u ndal veçanërisht te lufta kundër korrupsionit duke nënvizuar se rruga e ndjekur do të jetë gjithnjë e tillë dhe ne do të respektojmë forcimin e shtetit ligjor.

## ALEANCA



### Gjeneralmajor Bazo takon shefin e shkencës së NATO-s

Në 2015, pritet mbledhja e Bordit të NATO-s në Tiranë

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka zhvilluar një takim, në datën 28 mars 2014, me shefin e shkencës së NATO, gjeneralmajor Albert Husniaux. Gjeneral Bazo shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin maksimal për mbështetjen që NATO i ka dhënë Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura shqiptare në vite, si dhe theksoi rëndësinë e zhvillimit të Konferencës të katërt të Resurseve të NATO në Shqipëri. Më tej, gjeneral Bazo e ka njohur shefin e shkencës së NATO, gjeneral Husniaux me zhvillimet kryesore të Forcave të Armatosura, si dhe prioritetet për të ardhmen. Shefi i shkencës së NATO, gjeneral Husniaux falënderoi gjeneral Bazo për mbështetjen e dhënë për organizimin e “Konferencës së NATO për Resurset”, si dhe kërkoi mbështetjen për organizimin në vendin tonë të takimit të bordit të NATO, takim ky i cili do të mbahet në vitin 2015. Vizita e shefit të shkencës së NATO, gjeneralmajor Albert Husniaux u zhvillua në kuadër të konferencës së NATO-s për resurset, mbajtur në vendin tonë, e cila ka zhvilluar punimet nga data 22-30 mars 2014.

## KDS, prezantim mbi të ardhmen e shkencës dhe teknologjisë në NATO

**Z**ëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Ruzhdi Kuçi, zhvilloi mesditën të datës 31 mars 2014, një takim kortezie me Shefin e Shkencës së NATO-s gjeneralmajor Albert Husniaux, i cili ndodhej në Shqipëri në kuadër të zhvillimit të Konferencës të katërt të Resurseve të NATO-s. Në takim mori pjesë dhe komandanti/rektori i AFA-së, prof. dr. asoc. kolonel Agim Sula. Kolonel Kuçi pasi uroi për mirëseardhjen, u shpreh se ndjehet i nderuar për vizitën duke e njohur Shefin e Shkencës së NATO-s, gjeneralmajor Husniaux, me misionin, strukturën dhe detyrat që Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes kryen, në procesin e arsimit dhe trajnimit në Forcat e Armatosura, në të gjitha nivelet e arsimit dhe kualifikimit, për personelin oficer, nënoficer, ushtar profesionist e civil. Nga ana e tij, gjeneralmajor Albert Husniaux, pasi falënderoi për mikpritjen, theksoi rëndësinë që ka procesi o arsimit për edukimin e brezave të rinj. Ndër të tjerash ai theksoi se: “Mendoj se arsimit është shumë i rëndësishëm. Kjo është edhe arsyeja pse e vlerësoj mundësinë që më është dhënë për të dialoguar me kursantët tuaj. Ajo që ne bëjmë është shpërndarja e dijes, - jo vetëm ne por edhe të rinjtë japin ide, d.m.th arsimit funksionon si një proces i ndërsjellët”. Në vijim, në mjediset e auditorit, me audiencën e KLO, KKSHP, KTHOSH, profesorë e stafi pedagogjik i AFA, gjeneralmajor Albert Husniaux zhvilloi një prezantim në lidhje me Organizatën e Shkencës dhe Teknologjisë së NATO-s, misionin, detyrat që ajo kryen; vendin që Shqipëria zë në këtë organizatë si dhe një panoramë mbi të ardhmen e NATO-s në fokusin e inovacioneve të shkencës e teknologjisë. Qëllimi i prezantimit ishte në sinkron të plotë dhe me qëllimin që pati në vetvete konferenca e 4-t e resurseve të NATO-s, për mbështetjen, rritjen e besimit në përdorimin e fondeve të përbashkëta, krijimin e njohjeve, mirëkuptimit dhe përkrahje për punën në vazhdimësi të zyrave qendrore të NATO dhe gjithashtu promovimin për rritjen e bashkëpunimit efektiv mes pikëpamjeve dhe shqetësimeve të ndryshme të shteteve anëtare, pjesë e së cilës është dhe Shqipëria.

## Gjeneralmajor Bazo priti atasheun ushtarak gjerman, nënkolonel Guido Altendorf

Synohet bashkëpunim në fushën akademike me Gjermaninë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka pritur në datën 2 prill 2014, në një takim kortezie, atasheun ushtarak gjerman, nënkolonel Guido Altendorf. SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, arritjet e rezultateve të mira në zhvillimin e përbashkët të koncepteve të arsimit ushtarak, zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore të akademike, përgatitjet dhe kualifikimin e pedagogëve shqiptarë, për vlerësimin e arsimit tonë ushtarak mbi baza shkencore e bashkëkohore dhe në përputhje me standardet perëndimore si dhe bashkëpunimin në fushën e mjekësisë. Nga ana e tij nënkolonel Guido Altendorf, ka rikonfirmuar thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve tona, si dhe ka kërkuar mundësimin nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm të FARSH, për ndjekjen e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes për vitin akademik 2014-2015, të një përfaqësuesi ushtarak gjerman.

## Gjeneralmajor Bazo, takim me atasheun ushtarak italian, gjeneral Dell'Edera

Premtohen dimensione të reja bashkëpunimi

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka pritur në datën 1 prill 2014, në një takim kortezie, atasheun ushtarak italian, rezident në vendin tonë, gjeneral brigade Vito Dell'Edera. Gjeneral Bazo vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, si dhe shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin maksimal për mbështetjen që qeveria dhe Forcat e Armatosura të Italisë kanë dhënë për Forcat e Armatosura shqiptare për gjatë këtyre viteve. Atasheu ushtarak italian, gjeneral brigade Vito Dell'Edera, pasi falënderoi gjeneral Bazon për pritjen e ngrohtë dhe miqësore, vuri theksin në rëndësinë e zbatimit të plotë të planit të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes për vitin 2014. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën bindjen se bashkëpunimi midis dy vendeve tona do të njohë dimensione të reja edhe në të ardhmen, jo vetëm si vende fqinje por edhe në kuadër të Aleancës.

## Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes, takim me shefin e shkencës së NATO

Nëndrejtori i Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes Kolonel (R) Thimi Hudhra së bashku me personelin e QKSM më datë 31 mars 2014, priti në një takim shefin e shkencës së NATO-s, gjeneralmajor Albert Husniaux. Pas ceremonisë së pritjes, nëndrejtori i QKSM, kolonel (r) Thimi Hudhra bëri një prezantim të QKSM duke e njohur gjeneralin me misionin dhe detyrat kryesore, strukturën organizative, departamentet, metodologjinë dhe filozofinë e punës në QKSM, arritjet kryesore në vitin 2013 si dhe objektivat dhe planet për vitin 2014 e në vazhdim. Shefi i Shkencës së NATO-s, gjeneral Husniaux pasi falënderoi kolonel (r) Thimi Hudhra për prezantimin e QKSM, bëri gjithashtu një prezantim mbi Organizatën e Shkencës dhe Teknologjisë së NATO-s (NATO STO). Pas prezantimeve u shkëmbyen mendime për ecurinë e të mëtejshme midis dy institucioneve dhe gjeneralmajor Albert Husniaux u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në disa drejtime si: Shkëmbimi i eksperiencës, pjesëmarrja e QKSM në aktivitetet që organizon STO, dhënie asistencë me ekspertë të fushës, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta, shfrytëzimi i materialeve si dhe shkëmbime on-line. Vizita e shefit të shkencës së NATO-s, gjeneralmajor Albert Husniaux u zhvillua në kuadër të konferencës së NATO për resurset në vendin tonë, takim i cili u organizua në datat 22-30 mars 2014.



# Certifikohen grup-depot e Mbrazhdanit në Berat dhe Guakut në Skrapar

Merr pjesë sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Arjan Kraja

U certifikuan së fundi, grup-depot e Mbrazhdanit të Beratit dhe të Guakut në Skrapar. Në këtë operacion kanë marrë pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Arjan Kraja, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Viktor Berdo dhe përfaqësuesi të CUBIK-ut. Operacionin për të marrë kartën e pastërtisë dhe për t'i dorëzuar pushtetit lokal grup-depot e Mbrazhdanit, të cilat përbëheshin nga 12 depo nëntokësore dhe grup-depot e Guakut, të cilat përbëheshin nga 9 depo nëntokësore, e ka drejtuar komandanti i Brigadës Logjistike gjeneral-brigade Syrja Gjoka. Në ceremoninë e zhvilluar në Mbrazhdan të Beratit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Arjan Kraja, falënderoi në emër të ministres së Mbrojtjes efektivin e Brigadës, komandant e Batalioneve si dhe efektivin që ka shërbyer për shumë vjet në këto grup-depo. Ai vlerësoi punën e tyre vështirësitë, që kanë kapërcyer dhe e konsideroi operacionin e pastrimit të Shqipërisë nga municionet e tepërta si një sfidë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Brigadës Logjistike. "Keni kryer dy detyra të vështira, por janë në vazhdim dhe shumë të tjera ndaj dhe duhet përkushtim dhe përqendrim" - tha ai. Ndërsa gjeneralmajor Viktor Berdo tha se: "Për ta bërë ushtrinë shqiptare sa më eficiente më bashkëkohore dhe sipas standardeve të NATO-s duhet që të vazhdojë operacionin për pastrimin e grup-depove të largëta që të çlirohemi nga impenjime që u ka kaluar koha." Ai falënderoi në emër të Shtabit të Përgjithshëm të FA të gjithë efektivin e Mbrazhdanit. Një vlerësim objektiv dhe real për punën e sakrificat e efektivit bëri dhe komandanti i Brigadës Logjistike gjeneral-brigade Syrja Gjoka, i cili tha se puna e koordinuar e komandantit të Batalionit të Furnizimit nënkolonel Edmond Doda, e komandantit të Batalionit të Armatimit nënkolonel Arjan Rroshi e komandantit të Batalionit të Transportit nënkolonel Arjan Qirko dhe veçanërisht kontributi dhe përkushtimi i specializuar i Qendrës AME të drejtuar nga nënkolonel Ajet Dalti ka shpër në suksesin e këtij operacioni me shumë rëndësi për vitin 2014, por dhe për 10 grup-depot që janë certifikuar për këtë vit. Këta komandantë kanë bërë të mundur që të realizojnë me përkushtim detyrat, por dhe të mbajnë të gjitha ekuilibrat me urtësi në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe materiale. Një punë të madhe ka kryer efektivi i Rajonit të Beratit dhe konkretisht efektivi i repartit të Mbrazhdanit ka bërë të mundur që të arrihet një objektiv shumë i rëndësishëm i vitit 2014 i vendosur nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA. Fjala e parë shkoi në respekt të punës së këtyre ushtarakëve dhe civilëve, të cilët për disa muaj rresht arritën që të pastronin 12 tunelet. Këtu ka pasur municione që ruheshin në 12 depo nëntokësore. Në këto grup-depo janë administruar rreth 4500 ton municione. Në operacionin e fundit të zhvilluar nga



mesi muajit shkurt deri më 15 mars të vitit 2014 u zhvendosën rreth 800 ton municione, prej të cilave 250 ton në Mirakë, Elbasan për rezervë të FA dhe 550 ton për Vertop të Beratit në interes të ndërmarrjes MEICO. Në operacion shumë të vështirë dhe me përgjegjësi të madhe u angazhuar 15 vetë, 8 civilë dhe 7 ushtarakë për ngarkim shkarkim nën drejtimin e komandantit të objektit toger Tanku dhe rreshteri të palodhur Dashmir Pasha. Pas boshatisjes filloi pastrimi i objektit dhe territorit sipas standardeve. Me gjithë kushtet e vështira të terrenit dhe motit operacioni në këto grup-depo përfundoi me sukses. Në këto grup-depo shërbenin 15 ushtarakë dhe 2 civilë punëtorë ngarkim-shkarkimi. Falënderimet shkojnë për tërë këtë efektivi që realizoi këtë operacion shumë të vështirë dhe me përgjegjësi e për shtabin e Brigadës që drejtoi dhe udhëhoqi këtë punë. Po

kështu u vlerësua dhe operacioni për certifikimin e Guakut ku Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Arjan Kraja, tha se: "Sot bëhet kurorëzimi i punës disa vjeçare të efektivit të Rajonit të Beratit kësaj njësie të rëndësishme të Brigadës Logjistike. Në radhë të parë vlerësojmë dhe çmujmë punën e këtij efektivi i cili ka punuar me shumë përkushtim me korrektësi në kushte të vështira terreni moti duke ja dalë mbanë ta kthejë në një zonë të pastruar Guakut". Këto grup-depo kanë pasur municione që ruheshin në 10 depo nëntokësore. Municionet kanë qenë nga më të ndryshmet duke filluar nga municion artilerie i kalibrave të ndryshëm por dhe municion këmbësorie i cili paraqiste vështirësi të mëdha për shkak të vjetërisë së tij. Në këto grup-depo janë administruar rreth 5000 tonë municione. Aktualisht në operacionin e fundit që u zhvillua nga fillimi i muajit

mars deri më datë në mesin e këtij muaji, e cila është periudha e sulmit dhe gjatë kësaj kohe u zhvendosën 410 ton fishekë këmbësorie të planifikuara për rezervë në grup-depot Mirakë, Elbasan. Gjatë këtij operacioni u angazhuar 12 veta, 7 punëtorë civilë dhe 5 ushtarë për ngarkimin e municioneve në drejtimin e komandantit të Rajonit Berat nënkolonel Agron Budlla dhe përgjegjësit të objektit tetar Pëllumb Hysenbelliu dhe magazinierit të palodhur rreshter Krenar Duro. Gjatë transportit dhe pastrimit të grup-depove nuk ka pasur asnjë incident apo ngjarje në drejtim të zbatimit të rregullave të sigurisë teknike. Në këto grup-depo shërbenin 13 ushtarakë. Gjeneral-brigade Syrja Gjoka tha se: "Në vlerësim të kësaj detyre të rëndësishme falënderojmë tërë efektivin e kësaj njësie, Ministrinë e Mbrojtjes për mbështetjen dhe Shtabin e Përgjithshëm që ka ndjekur me kujdes dhe hap pas hapi këtë proces deri sa kemi mbërritur në këtë ditë".

Sot merr fund një prej operacioneve më të vështira të betejës së madhe të asgjësimit të municioneve të dala jashtë përdorimit. Efektivi i Rajonit të Beratit dhe konkretisht efektivi i repartit të Mbrazhdanit ka bërë të mundur që të arrihet një objektiv shumë i rëndësishëm i vitit 2014 i vendosur nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA. Fjala e parë shkoi në respekt të punës së këtyre ushtarakëve dhe civilëve, të cilët për disa muaj rresht arritën që të pastronin 12 tunelet.

Bashkim Male

## Zhvillohet ceremonia e përfundimit të kursit bazë të gjuhës turke

Në mjediset e Qendrës së Gjuhëve të Huaja, mesditën e datës 27 mars 2014 u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit bazë të gjuhës turke. Në këtë ceremoni morën pjesë Ambasadori i Turqisë në vendin tonë, Hidajet Bayraktar, zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, Sekretari i Përgjithshëm i MM, Arian Kraja, atashu ushtarak turk i akredituar në vendin tonë, kolonel Nizamettin Dogar, shefi i shtabit të KDS-së, kolonel Riza Zaja, drejtorë të drejtorive të MM e SHP, përfaqësues të KDS etj. Në fjalën e rastit, atashu ushtarak turk i akredituar në vendin tonë, kolonel Nizamettin Dogar, pasi falënderoi të pranishmit për prezencën në këtë aktivitet, dha për të ftuarit një panoramë përmblendhëse të këtij kursi. Ndër të tjerash, Kolonel Dogar, vlerësoi mbështetjen nga personeli i QGJH, institucioni i KDS, punën, përkushtimin dhe përgjegjshmërinë e dy trajnuesve të gjuhës së huaj, nënkolonel Nazmi Daka dhe kapiten Destan Muça si dhe seriozitetin dhe angazhimin e kursantëve shqiptarë në përvetësimin në nivel pozitiv të gjuhës turke. Në këtë aktivitet, në emër të 9 kursantëve të ardhur nga njësi të ndryshme të FA, përshëndeti dhe nënoficer Altin Hoxha. Ceremonia vijoi me shpërndar-



jen e certifikatave, duke u përmblytur me realizimin e një fotoje të përbashkët dhe kokteji. Kursi themelor i gjuhës turke është një kurs që është hapur në bazë të marrëveshjes bilaterale të bashkëpunimit midis të dy vendeve mike, i hapur për herë të parë në vitin 1992, e me një kohëzgjatje prej 4 muajsh. Trajnimi në këtë kurs kryhet nëpërmjet trajnuesve shqiptarë të trajnuar më parë në Turqi. Deri tani në këtë kurs janë certifikuar për afro 112 kursantë, personel i njësive e reparteve të ndryshme të FA. Më tej kursantët e këtij kursi kalojnë në kurse të tjera kualifikimi në shkollat respektive në Turqi.

## Studentë të Qendrës së Gjuhëve të Huaja, ditë mësimore në FD

Në kuadrin e procesit mësimor për realizimin e programit të përvetësimit të gjuhës angleze dhe gjuhës operacionale me kursantet e nivelit 3/3/3, pedagogët e gjuhës angleze të QGJH, në bashkëpunim me kursantët e këtij niveli më datën 2 prill 2014 zhvilluan një ditë mësimore në Komandën e FD për operacionet e shpëtimit në det. Qëllimi kryesor ishte njohja me misionin e FD dhe me disa koncepte operacionale që kanë të bëjnë me të, si rëndësia e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det, roli i FD në operacionet SAR, etj. Fillimisht ushtarakëve anglistfolës i uroi mirëseardhjen shefi i Degës Operacionale të FD, kapiten i rangut të II-të, Engjëll Sinanaj, i cili bashkë me kolegët e degës i krijoi kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të kësaj dite mësimore studentëve të QGJH. Në vijim kapiten lejtant Emrush Bejdo, specialist në degën operacionale të FD, prezantoi në gjuhën angleze misionin e FD, detyrat kryesore, operacionet e kërkim shpëtimit SAR, rëndësinë e tyre, rolin e FD në këto operacione si dhe statistika e të dhëna për operacionet e zhvilluara vitin e kaluar dhe muajt e parë të këtij viti. Prezantimi u ndoq me interes nga pjesëmarrësit, të cilët bënë pyetje të shumta për aktivitetin e FD dhe të ardhmen e saj. Ndërkohë pedagogu Vjollca Buçpapaj pyeti për operacionet e përbashkëta të FD me partnerët e NATO-s. Në fund të pjesës teorike, pedagogu Shqiponja Dautaj, drejtorë e QGJH, falënderoi kuadrin e FD për masat e mara në mbarrëvajtjen e kësaj dite mësimore, ku studentët e Qendrës u njohën me terminologjinë detare në anglisht dhe gjuhën operacionale. Në fund grupi i QGJH vizitoi anijen tonë "Iliria", ku komandanti i saj, kap. It. Edison Hoxha, i shpjegoi në anglisht kursantëve të QGJH, të dhënat e anijes dhe rolin e saj në operacionet e zhvilluara.

Sh. K.





Zhvillohet në Bruksel Ministeriali i Jashtëm i NATO-s

# Kriza e Ukrainës kryesoi axhendën dy-ditore të bisedimeve së Ministerialit të Jashtëm së NATO-s

**M**bështetja e NATO-s ndaj Ukrainës dhe rishikimi i marrëdhënieve me Rusinë në prag të krizës së Ukrainës, kryesuan axhendën e takimit dy-ditor të ministrave së Jashtëm të NATO-s, i cili u zhvillua nga 1-2 prill 2014. Ministrat e Jashtëm diskutuan gjithashtu marrëdhëniet e NATO-s me Gjeorgjinë, situatën në Afganistan, bashkëpunimin e Aleancës me partnerët e saj të Gjirit si dhe përgatitjet për samitin e NATO-s, i cili do të zhvillohet në Uells, në muajin shtator të këtij viti. Sesioni i parë i punës u fokusua në rritjen e mbështetjes ndaj Ukrainës dhe në pasojat e veprimeve ushtarake ilegale të Rusisë kundër Ukrainës për marrëdhëniet NATO-Rusi. Gjithashtu, ata diskutuan mënyrat për të përmirësuar punën e NATO-s me vendet partnere, duke përfshirë mbështetjen në ato shtete të cilët duan të forcojnë e të reformojnë sektorin e tyre të sigurisë. Më pas, ministrat e Jashtëm të NATO-s u takuan me homologun e tyre ukrainas, Andrii Deshchytzia, në një seancë të Komisionit NATO-Ukrainë. Kjo ishte një mundësi për të marrë vendime se si Aleanca mund të mbështesë më tej Ukrainën me reformat e saj të mbrojtjes. Më 1 prill, ministrat e Jashtëm festuan gjithashtu dhe përvjetorin e zgjerimeve të shkuara që nga viti 1999 dhe theksuan suksesin historik të zgjerimit për sigurinë dhe stabilitetin në Europë. Bisedimet e ditës së dytë filluan me një takim të Komisionit NATO-Gjeorgji me ministren e Jashtëm gjeorgjiane, Maia Panjikidze. Takimi me ministrat nga katër vendet e Gjirit që marrin pjesë në Nismën e Bashkëpunimit të Stambollit (ICI), Bahreini, Katari, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, shënoi 10-vjetorin e bashkëpunimit dhe kërkuan për bashkëpunim të mëtejshëm. Ministeriali u mbyll me një takim mbi Afganistanin me homologët nga vendet partnere, të



cilët kontribuojnë në misionin e ISAF-it. Ministrat trajtuan zgjedhjet e ardhshme afgane dhe evidentuan progresin në operacionin e ISAF-it të udhëhequr nga NATO si dhe planifikimin për misionin e ardhshëm për të trajtuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane të sigurisë.

## Ministrat e Jashtëm të NATO-s riafirmojnë angazhimin për mbrojtjen kolektive

“Ministrat e Jashtëm të NATO-s treguan përkushtimin e tyre të palëkundur ndaj mbrojtjes kolektive aleate në prag të krizës së Ukrainës”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në fillim të takimit ministror dy-ditor. “Mbrojtja fillon me pengesa ndaj rreziqeve, kështu që ne do të ndërmarrim hapat e nevojshëm për t’ia bërë botës të qartë se asnjë kërcënim kundër aleatëve të NATO-s nuk do të ketë sukses”, tha ai. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës “sfidon vizionin tonë për një Europë

të tërë, të lirë dhe në paqe. Ai ndryshon krejtësisht peizazhin e sigurisë së Europës dhe kjo shkakton paqëndrueshmëri në kufijtë e NATO-s. Ne do të biem dakord rreth mënyrave për të mbështetur partneren tonë Ukrainën me masa politike dhe praktike në kuadër të partneritetit tonë afatgjatë. Një Ukrainë e pavarur, sovranë dhe e qëndrueshme, e vendosur për të ruajtur demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pakicave dhe shtetit të së drejtës, është çelësi për sigurinë euroatlantike”, tha Rasmussen. Ai tha gjithashtu se ministrat do të bëjnë të qartë se veprimet e Rusisë janë të papranueshme. “Ne do të marrim vendime mbi të cilat bashkëpunimi me Rusinë është ende i përshtatshëm, sepse nëpërmjet veprimeve të saj, Rusia ka minuar parimet mbi të cilat është ndërtuar partneriteti ynë si dhe ka shkelur angazhimet e saj ndërkombëtare. Pra, ne nuk mund të bëjmë biznes me të si zakonisht”, u shpreh Sekretari i Përgjithshëm.

## Deklaratë nga Ministrat e Jashtëm të NATO-s

Ne, ministrat e Jashtëm të NATO-s, jemi të bashkuar në dënimin tonë për ndërhyrjen ushtarake ilegale nga ana e Rusisë në Ukrainë dhe Rusia po shkel sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ne nuk e njohim “aneksimin” e paligjshëm dhe jo legjitim të Rusisë në Krimë. Ne i bëjmë thirrje Rusisë të ndërmarrë hapa të menjëhershëm, siç është përcaktuar në deklaratën e Komisionit NATO-Rusi të veprojë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, detyrimet e përgjegjësitë e saj ndërkombëtare si dhe të angazhohet menjëherë në një dialog të vërtetë drejt një zgjidhjeje politike dhe diplomatike që respekton ligjin ndërkombëtar dhe kufijtë e Ukrainës të njohur ndërkombëtarisht. Ne e mbështesim vendosjen e një sistemi monitorues të OSBE-së në Ukrainë.

Qëllimi ynë për një rajon euroatlantik të tërë, të lirë dhe në paqe nuk ka ndryshuar, por është sfiduar fundamentalisht nga Rusia. Ne mbështesim sovranitetin, pavarësinë politike dhe integritetin territorial të të gjithë shteteve brenda kufijve të tyre të njohur ndërkombëtarisht. Një Ukrainë e pavarur, sovranë dhe e qëndrueshme, e vendosur të respektojë demokracinë, të drejtat e njeriut, pakicave dhe shtetit të së drejtës, është çelësi për sigurinë euroatlantike.

Për të treguar angazhimin tonë për Ukrainën, ne do të intensifikojmë bashkëpunimin tonë në kuadër të Partneritetit Dallues. Sot, NATO dhe Ukraina kanë rënë dakord, siç u përcaktua në deklaratën e Komisionit NATO-Ukrainë, të zbatojnë masa të menjëhershme dhe afatgjata për të rritur

aftësinë e Ukrainës në mënyrë që të garantojë sigurinë e vet.

Gjithashtu, ne sot ramë dakord për një paketë masash që kanë për qëllim thellimin e bashkëpunimit tonë me partnerët e tjerë të NATO-s në Europën Lindore, në konsultim me ta dhe brenda programeve tona ekzistuese dypalëshe.

Gjatë 20 viteve të fundit, NATO ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për bashkëpunim më të ngushtë dhe besim me Rusinë. Megjithatë, Rusia ka shkelur të drejtën ndërkombëtare dhe ka vepruar në kundërshtim me parimet dhe angazhimet e dhëna në Dokumentin Bazë të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik, Akti Themelues NATO-Rusi dhe Deklarata e Romës. Ajo ka shkelur rëndë besimin mbi të cilin duhet të bazohet bashkëpunimi ynë.

Ne kemi vendosur të pezullojmë të gjithë bashkëpunimin praktik civil dhe ushtarak ndërmjet NATO-s dhe Rusisë. Dialogu ynë politik në Këshillin NATO-Rusi mund të vazhdojë, sipas nevojës, në nivel ambasadorësh e më lart, për të na lejuar ne të shkëmbejmë pikëpamje, në radhë të parë në këtë krizë. Në do të rishikojmë marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë në takimin tonë të ardhshëm në muajin qershor.

Siç u tha nga krerët e shteteve dhe qeverive tona në samitin e Çikagos në vitin 2012, NATO është bazuar në solidaritetin, kohezionin e Aleancës dhe pandashmërinë e sigurisë tonë. Në situatën aktuale, Aleanca tashmë ka marrë hapa për të demonstruar solidaritetin si dhe për të forcuar aftësinë e saj për të parashikuar e për t’iu përgjigjur me shpejtësi çdo sfide ndaj sigurisë së Aleancës. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë përforsim të duhur dhe garanci të dukshme të kohezionit dhe angazhimit të NATO-s për mbrojtjen kolektive ndaj çdo kërcënimi të mundshëm agresioni ndaj Aleancës.



Rasmussen: Politika e dyerve të hapura të NATO-s,  
një nga historitë më të suksesshme të kohës sonë

# Ministrat e Jashtëm të NATO-s shënojnë jubiletë historikë të pranimit: 1999, 2004, 2009

Ministrat e Jashtëm të NATO-s theksuan suksesin historik të Politikës së Dyerive të Hapura të Aleancës duke shënuar tre jubile të rëndësishëm, të cilët kanë përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë Europën që nga fundi i Luftës së Ftohtë. 15 vjet më parë, Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia u bashkuan me NATO-n. Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia u bënë anëtare të Aleancës 10 vjet më parë dhe kanë kaluar 5 vjet që nga anëtarësimi i Shqipërisë dhe Kroacisë. “Politika e dyerve të hapura të NATO-s ka qenë një nga historitë më të suksesshme të kohës sonë. Krahas zgjerimit të Bashkimit Europian, kjo ka ndihmuar për të zhdukur shumë prej linjave të dhimbshme ndarëse në kontinentin tonë dhe na ka sjellë më pranë qëllimit tonë për një Europë të tërë, të lirë e ne paqe”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ministrat e të 28 vendeve anëtare u mbledhën për një foto të veçantë familjare për të përkujtuar jubiletë dhe i uruan homologët e tyre aleatë që po festojnë jubiletë e tyre këtë vit. Rasmussen tha se dyert e Aleancës mbeten të hapura “për të gjitha demokracitë europiane që ndajnë vlerat tona, të cilat marrin përsipër përgjegjësitë e anëtarësimi dhe që mund të kontribuojnë në sigurinë e zonës euroatlantike”. Ai shtoi se kriza e Ukrainës rrezikon krijimin e linjave të reja ndarëse në Europë dhe kjo vë në dyshim parimet mbi të cilat është ndërtuar Europa moderne, integriteti territorial, e drejta ndërkombëtare dhe e drejta e shteteve sovraane për ta zgjedhur vetë fatin e tyre. “Duke u ngritur për këto parime, ne kemi ndihmuar në përhapjen e lirisë, paqes dhe stabilitetit në të gjithë Europën. Ne kemi shëruar ndarjet e së kaluarës e kemi kapërcyer konfliktet që kanë zgjatur nëpër breza”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai theksoi se NATO do të vazhdojë të qëndrojë përkrah Ukrainës, “në mbështetje të integritetit territorial dhe sovranitetit të partnerëve tanë dhe ne do të vazhdojmë të ruajmë lirinë në mënyrë që të mbizotërojë paqja”.

## Ministrat e Jashtëm të NATO-s përsërisin mbështetjen për integritetin euroatlantik të Gjeorgjisë

Ministrat e Jashtëm të NATO-s u takuan me homologen e tyre gjeorgjiane, Dr. Maia Panjikidze, në Komisionin NATO-Gjeorgji më 2 prill, për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi përparimin e Gjeorgjisë në zbatimin e reformave dhe rreth zhvillimeve në Gjeorgji dhe rajon. “Ndërkohë që vendi aspiron të bashkohet me Aleancën tonë, Gjeorgjia është një partner e veçantë e NATO-s dhe e vlerësojmë shumë dialogun tonë politik e bashkëpunimin praktik”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. Gjatë takimit, ministrat diskutuan krizën e shkaktuar nga agresioni ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës. “Në këtë kohë, është më e rëndësishme se kurrë të theksohet se shkelja e integritetit territorial dhe sovranitetit është e papranueshme. Kombet kanë të drejtën të bëjnë zgjedhjet e tyre të lirave këto zgjedhje duhet të respektohen nga të gjithë”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Aleatët e NATO-s theksuan mbështetjen e tyre të fuqishme për sovranitetin dhe integritetin territorial brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht dhe mbështetjen e vazhdueshme të Gjeorgjisë për aspiratat euroatlantike. Gjithashtu, ministrat shprehën mirënjohje për kontributin e shquar të Gjeorgjisë në operacionet e NATO-s dhe sigurisë euroatlantike. “Ju jeni vendi më i madh jo-anëtar i NATO-s që kontribuoni me trupa në misionin tonë në Afganistan. Ju jeni angazhuar të për të kontribuar në Misionin tonë Mbështetje e Vendosur dhe ne mirëpresim vendimin tuaj për të marrë pjesë në Forcën e Reagimit të NATO-s”, tha Rasmussen. Ai shtoi: “Ju keni bërë progres të shquar me reformat ambicioze demokratike dhe të mbrojtjes. Progresi



i mëtejshëm do të kërkojë bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet qeverisë dhe opozitës. Pas zgjedhjeve presidenciale së vitit të kaluar, zgjedhjet e ardhshme lokale në qershor do të jenë një tjetër moment i rëndësishëm për pjekjen e demokracisë gjeorgjiane. Gjeorgjia mund të bëhet një model për rajonin”.

## NATO dhe vendet e Gjirit të vendosur të thellojnë bashkëpunimin

Ministrat e Jashtëm të NATO-s u takuan me homologët e tyre nga Nisma e Bashkëpunimit të Stambollit, (ICI), Bahrejn, Kuvajti, Katar dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Ky ishte takimi i parë i ministrave të Jashtëm me vendet e ICI që nga nisja zyrtare e kësaj iniciative në Samitin e NATO-s në Stamboll në qershor të vitit 2004. “Nisja e iniciativës sonë

10 vite më parë ishte një sinjal i qartë. Siguria dhe stabiliteti i rajonit të Gjirit është një interes strategjik për NATO-n, ashtu si siguria dhe stabiliteti i zonës euroatlantike kanë rëndësi për rajonin e Gjirit”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Ne duhet të mbrojmë kufijtë tanë detarë, rrugët e furnizimit me energji dhe rrjetet kibernetike. Ne përballemi me sfida komplekse dhe të ndërlydhura të sigurisë, të tilla si terrorizmi, pirateria dhe riprodhimi i armëve. Këto janë sfida që ne duhet t’i ndalojmë së bashku”, theksoi ai. Rasmussen u shpreh se “gjatë dekadës së fundit, dialogu dhe bashkëpunimi ynë janë intensifikuar në mënyrë të qëndrueshme. Nga Bosnja në Kosovë dhe nga Afganistani në Libi, partnerët tanë të Gjirit kanë dhënë një kontribut të vlefshëm në operacionet e drejtuara nga NATO”. Ministrat

e Jashtëm të NATO-s dhe partnerët e tyre nga Rajoni i Gjirit në ICI diskutuan se si të vazhdojnë të thellojnë partneritetin ekzistues dhe se si Aleanca mund të punojë më ngushtë me të gjitha vendet e Gjirit për të ndërtuar një marrëdhënie të vërtete strategjike ndërmjet zonës euroatlantike dhe rajonit të Gjirit. “Ndërsa presim Samitin e Uellsit në shtator, ne do të punojmë në mënyrat për të thelluar dialogun tonë politik dhe bashkëpunimin praktik. Gjithashtu, do të diskutojmë se si mund ta vazhdojmë bashkëpunimin tonë që t’i mundësojmë partnerëve tanë të Gjirit nevojat specifike të sigurisë”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Gjatë 10 viteve të fundit të partneritetit të tyre me Aleancën, vendet e ICI janë bërë ofrues efikas i sigurisë si dhe kanë kontribuar në përpjekjet ndërkombëtare

për të mbrojtur stabilitetin dhe sigurinë, duke përfshirë operacionet e misionit të NATO-s në Afganistan, ISAF dhe Operacionin Mbrojtësi i Unifikuar në Libi, në vitin 2011. Nisma e Bashkëpunimit të Stambollit ofron një meny të larmishme të aktiviteteve bashkëpunuese praktike nga të cilat vendet e ICI mund të zgjedhin. Këtu përfshihen, mes të tjerash, këshilla për transformimin e mbrojtjes, buxheti i mbrojtjes dhe marrëdhëniet civilo-ushtarake, bashkëpunimi ushtarak duke përfshirë stërvitjet e zgjedhura ushtarake, planifikimi i emergjencave civile si dhe aktivitetet e përbashkëta të diplomacisë publike.

## Ministrat e ISAF-it lavdërojnë forcat afgane të sigurisë përpara zgjedhjeve historike afgane

Ministrat e Jashtëm të NATO-s dhe homologët nga vendet partnere të ISAF-it u takuan me zëvendësministrin e Jashtëm afgan, Ahmadi, më 2 prill për të rishikuar progresin e misionit të ISAF-it si dhe për të vlerësuar përgatitjet përfundimtare për zgjedhjet afgane të këshillit presidencial dhe krahinor, të planifikuara më 5 prill 2014. “Ndërkohë që ISAFI do të ofrojë mbështetje kur është e nevojshme, forcat afgane janë në krye të vendit dhe gjatë gjithë përgatitjeve për zgjedhjet, ato kanë treguar përkushtim, kurajë dhe profesionalizëm”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, pas mbledhjes. “Është jetike që zgjedhjet të jenë të besueshme, përfshirë dhe transparente, në mënyrë që rezultati i tyre të jetë i pranueshëm për popullin afgan dhe që çdo shkelje e supozuar të adresohet me shpejtësi, përmes institucioneve të krijuara”, shtoi Sekretari i Përgjithshëm. Gjithashtu, ministrat diskutuan mbështetjen e tyre të vazhdueshme për Afganistanin deri në fund të këtij viti, përmes misionit të ISAF-it si dhe pas vitit 2014, përmes misionit të ri, Mbështetja e Vendosur, për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane të sigurisë. “Ne qëndrojmë me angazhimet tona në Afganistan, por sa më shumë kohë të duhet për marrëveshjet që të nënshkruhen, aq më pak do të jemi në gjendje të bëjmë. Ky nuk është përfundimi ynë i dëshiruar, por nëse nuk ka marrëveshje, nuk do të ketë mision”, tha Rasmussen. Gjithashtu, në këtë takim mori pjesë edhe një përfaqësues i Zyrës së Lartë Përfaqësuese të Bashkimit Europian për Çështjet e Jashtëm.

Alba Musaraj

## ALEANCA

# Emërohet Sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s

Këshilli i Atlantikut të Veriut vendosi më 28 mars të emërojë z. Jens Stoltenberg si Sekretar të Përgjithshëm të NATO-s dhe kryetar të Këshillit të Atlantikut të Veriut, si pasues i Anders Fogh Rasmussen. Zoti Stoltenberg do të marrë funksionet e tij si Sekretar i Përgjithshëm duke filluar nga 1 tetori 2014, kur do të përfundojë mandatin e z. Anders Fogh Rasmussen, pas 5 vjet e 2 muajsh në krye të Aleancës.

### Kush është Jens Stoltenberg?

Jens Stoltenberg ka lindur në Oslo të Norvegjisë, më 16 mars të vitit 1959. Ai i kaloi vitet e tij të fëmijërisë jashtë vendit me babain e tij diplomat, nënën dhe dy motrat. Stoltenberg ka një diplomë pasuniversitare në Ekonomi nga Universiteti i Oslos. Pas diplomimit në vitin 1987, ai filloi punën në fushën e statistikës në Norvegji. Në vitin 1990, ai u thirr nga kryeministri Gro Harlem Brundtland për të shërbyer si Sekretar i Shtetit për Mjedisin. Në vitin 1993, ai u zgjodh anëtar i Parlamentit në Oslo si dhe u emërua gjithashtu ministër i Tregtisë dhe Energjisë. Ai ka

shërbyer si ministër i Financave nga viti 1996 deri në vitin 1997. Jens Stoltenberg u emërua kryeministër për herë të parë në vitin 2000, në moshën 40-vjeçare. Ai u tërhoq pas zgjedhjeve të vitit të ardhshëm dhe ishte lider i opozitës deri në vitin 2005, kur u bë edhe një herë kryeministër, këtë herë për një qeveri koalicioni, një post që ai e mbajti deri në tetor të vitit 2013. Aktualisht, ai është lider i Partisë Laboriste Norvegjeze si dhe udhëheqës parlamentar i partisë. Stoltenberg ka pasur një numër detyrash ndërkombëtare. Këto përfshijnë kryesimin e panelit të nivelit të lartë të OKB-së mbi Koherencën e Gjerë të Sistemit dhe Grupit të Nivelit të Lartë Këshillimor mbi Financimin e Ndryshimeve Klimaterike. Aktualisht, ai është i dërguari i Posaçëm i OKB-së mbi Ndryshimet Klimaterike. Ndërkohë që Stoltenberg ishte kryeministër, shpenzimet e mbrojtjes së Norvegjisë u rritën në mënyrë të qëndrueshme, me rezultat që Norvegjia është sot një nga aleatët me shpenzimet më të larta të mbrojtjes për frymë. Stoltenberg gjithashtu ka qenë i rëndësishëm në transformimin e Forcave të



Armatura Norvegjeze, përmes një fokusi të fuqishëm në aftësi e dislokueshme. Nën udhëheqjen e tij, Qeveria Norvegjeze, ka kontribuar me forca norvegjeze në operacione të ndryshëm të NATO-s. Gjatë qëndrimit të tij si kryeministër, Stoltenberg i ka bërë shpesh thirrje NATO-s të fokusohet në sfidat e sigurisë në afërsi të territorit aleat. Ai është një mbështetës i fuqishëm i bashkëpunimit të zgjeruar transatlantik, duke përfshirë ndarjen më të mirë të barrës përmes Atlantikut. Ai i sheh NATO-n dhe BE-në si organizata plotësuese në drejtim të sigurimit të paqes dhe zhvillimit në Europë dhe më gjerë. Stoltenberg është i martuar me Ingrid Schulerud. Së bashku ata kanë dy fëmijë të rritur.



Më datë 3 shkurt 2014 filloi kursi i 9-të funksional Komando. Nga 35 kursantë pjesëmarrës në fillim të kursit, nga skualifikimi nëpërmjet fazave kanë mbetur 23 kursantë. Kjo është sfida më të cilën përballen ushtarët profesionistë të dytë, nënoficerët dhe oficerët pjesëmarrës në këtë kurs selektiv për atë që nuk përmbushin objektivat e përcaktuara në programin 12 javorë të stërvitjes. Sfida për ta nuk ka mbaruar. Ajo mbyllet me testimin në përfundim të fazës së tretë të kryer nga trupa pedagogjike e Shkollë së Trupës.

Reportazh nga Batalioni Komando

# Kursi komando, një sfidë që nuk dhurohet, por fitohet

Major Nexhbedin Basha



“Boretat blu”, njihen efektivat e Batalionit Komando. Ata janë cilësuar si elita e Forcave të Armatosura. Krahas detyrave të planëzimit të vitit 2014, objektivi parësor është zhvillimi i stërvitjes dhe veçanërisht përmbushja e objektiveve të kursit të 9-të funksional komando, i cili ka startuar më 3 Shkurt 2014 dhe përfundon me certifikimin e kursantëve më 25 prill 2014. “Kursi komando është një sfidë për të gjithë pjesëmarrësit, i cili nuk dhurohet por fitohet”, kështu shprehet Komandanti i Batalionit Komando, Nënkolonel Besim Bala, kur e pyet për ecurinë e kursit dhe problematikat që trajtohen në të. Shqetësimi im – vijon ai – nuk është thjeshtë certifikimi që tashmë ky kurs njihet si kurs funksional në FA nga Shkolla e Trupës, e cila është institucioni arsimor certifikues, por sa dije përfituan pjesëmarrësit, për të qenë në një të ardhme të afërt, si instruktor në zhvillimin e mësimin të kurseve të radhës... Ai tregon se, periudha 8 mujore e mbetur e vitit 2014, do jetë një periudhë intensive për rritjen e performancës së efektivit të këtij batalioni në të gjitha disiplinat, plotësimi i standardeve sipas STANAG-ve, rezultate të cilat po evidentohen nëpërmjet testeve të vazhdueshme të personelit të këtij batalioni, si për ecurinë në karrierë, në planifikimin për kurset institucionale, për nëntetar, tetar, rreshter, kapter etj, po ashtu edhe për konsolidimin e punës për çdo efektiv në funksionin organik...”. Me të njëjtin shqetësim të komandantit punohet edhe nga të gjitha sektorët në batalion, si ai i personelit, operacioneve dhe stërvitjes, logjistikës, ndërldhjes, zbulimit, BCU etj. Major Isuf Bami, Shefi i personelit të këtij batalioni, shprehet se, “matësi më i mirë i punës për secilin efektiv të trupës komando është vlerësimi i çdo individi, ndaj dhe ne po punojmë për eliminimin e mangësive të dosjeve elektronike dhe hedhjen e të dhënave, praktikë kjo e cila, ka bërë që puna me personelit të bëhet e mirë menaxhueshme dhe konkrete për vlerësimin e secilit.”

Këto ditë ndoqem nga afër dinamikën e kursit të 9-të komando. Komandanti i këtij kursi, kapiten Altin Hazizi, shpjegon se nga 35 kursantë që nisën kursin, aktualisht e vazhdojnë atë 23, pra, 12 kursantë janë skualifikuar për mos arritjen e normave taktiko-fizike

nëpërmjet testeve të zhvilluara si në fazën e parë ashtu dhe në fazën të dytë. Ai shpjegon se, kursi komando ka katër instruktor nënoficer, puna e të cilëve është për t’u admiruar. Instruktorët, kapter Xhevdet Mezini, specialist i mbijetesës, rreshter Lulëzim Kuka, këshilltar kursi, rreshter Lulëzim Murati, specialist i taktikës e qitjes dhe rreshter Fatos Sulejmani, i përgatitjes fizike dhe i alpinizmit, janë me eksperiencë disa vjeçare në batalionin Komando dhe kanë përfunduar kursin komando vite më parë, të trajnuar në ish-Shkollën e Trupës Komando, nga instruktorë turq dhe shqiptarë. Aktualisht kursantët janë duke zhvilluar fazën e tretë e cila përkon me javën e nëntë dhe programi është fokusuar në përgatitjen taktiko-fizike të personelit dhe temat specifike të batalionit komando si, alpinizmi, kalimi i vijës së frontit si ditën ashtu edhe natën. Deri tani kursantët i janë nënshtruar dy testeve atij intelektual dhe fizik. Nëpërmjet testimit intelektual

janë evidentuar dijet e fituara në fushën ushtarake të ndara me specialitete dhe nëpërmjet atij fizik kondicioni fizik i tyre. Kursantët ushtarë profesionistë të dytë, nënoficer dhe oficer, duke e konsideruar disiplinën e përgatitjes fizike si një objektivi themelor, në kohën e lirë i gjen në palestër, duke u ushtruar me përkushtim në aktivitet fizik, në brezin e kalitjes, në poligonin e qitjes etj.

Gjatë këtij kursi kursantët janë përballur me ngarkesa fizike, psikologjike dhe të stresit. Para fillimit të tij u zhvillua testimi hyrës, për të parë gjendjen fillestare të kursantit dhe deri në përfundim të fazës së tretë që është faza finale, instruktorët dhe komandanti i kursit që është oficeri i vetëm dhe përgjegjës për këtë kurs, evidentojnë ecurinë e kursantëve gjatë tre fazave. Kapiten Hazizi, tregon se kursantët janë të motivuar dhe nga njëra fazë në tjetrën kanë shfaqur performancë në rritje të përgatitjes fizike dhe dijeve teorike.

Instruktori i taktikës, rreshter Lulzim Murati, tregon se me kursantët kemi zhvilluar stërvitje të natyrave të ndryshme, që u kanë shërbyer pjesëmarrësve për formimin si lider të stërvitjes. Mënyrat e kalimit të pengesave ujore, veprimet në prapavijë të kundërshtarit për asgjësimin e trupave armike dhe “hedhja e Tarzanit” në lartësi me pajimet dhe armatimin personal, kanë qenë disa temat që kemi zhvilluar. “Hedhja e Tarzanit”, - tregon instruktori, - ka një sprovë për komandot për nga shkalla e vështirësisë që mbart.” Këndi i mbijetesës i batalionit është funksional, shprehet kapter Xhevdet Mezini, instruktor i mbijetesës. Në të janë zhvilluar nga instruktorët disa elementë të krijimit të llojeve të zjarrit me mjete rrethore, në një terren me kushte të vështira, me mungesë të ujit dhe ushqimit.

Në programin 9 javor të stërvitjes zhvilluar nga instruktorët një zë të veçantë ka zënë lënda psikologjike. Kapite Manjola Kondili, psikologe e batalionit, shprehet se ndryshe nga kursi 8-të komando, në kursin e 9-të, duke u bazuar në mësimet e nxjerra në programin e stërvitjes me prioritet është parë dhe lënda psikologjike dhe kryesisht dhënia e njohurive për kursantët si njohja me pozicionin e psikologut, me mënyrat e menaxhimit të stresit, si të përballojmë panikun dhe ankthin gjatë një operacioni me ngarkesa fizike dhe psikologjike. Në lidhje me këtë, ajo qartëson se për të përcaktuar nivelin e ankthit dhe reagimet emocionale që shfaqen nga stresi, ne kemi përgatitur disa pyetësor të cilat janë plotësuar nga kursantët. Përveç këtyre, kemi zhvilluar edhe prezantime dhe bashkëbisedime për të përcaktuar problematikat me të cilat ata hasin gjatë stërvitjes. Në përfundim të kursit, do të ketë takime dhe intervista edhe me instruktorët dhe komandantit e kursit nga të cilët do të marrim informacion më të detajuar për nivelin e ngarkesës, stresit dhe

problematikat e ndryshme të evidentuara gjatë zhvillimit të kursit.

Pa hyrë në detaje, kursantët në këto ditë stërvitje kanë marrë njohuri për një gamë të gjerë disiplinash. Ata janë aftësuar në përdorimin dhe orientimin nëpërmjet hartës dhe busullës, veprimet praktike në gjetjen e këndeve azimutale në terren, si ditën dhe natën. Një kujdes i veçantë në program i është kushtuar njohjes së ligjshmërisë dhe specialiteteve si, zbulim, operacione, xhenjo, MADM, shëndetësi, ndërldhje, armatim etj. Përgatitja taktike, thotë shefi i shtabit i batalionit kapiten Pëllumb Hidri, ka zënë një vend të rëndësishëm në program dhe sidomos organizimi i grupit komando, veprimet në rajonin e bazimit, veprimet për kalimin e zonave të rrezikshme dhe zbulimin e objektit, prita, llojet e saj dhe organizimi i grupit në pritë si ditën dhe natën. Natyrisht nuk kanë qenë jashtë vëmendjes as përgatitjet alpiniste si, njohuri të përgjithshme mbi këto pajisje, lidhjet alpiniste dhe veprimet praktike, njohuri mbi urat alpine dhe ndërtimi i teleferikut, i shkallëve alpine, zbritjet nga kulla, veprime në shkëmb etj. Në këto ditë stërvitje temat: lufta në qendrat e banuara, mënyrat e hyrjes në godinë, përgatitja fiziko luftarake, vrapime 5 km, 8 km, 27 km me pajime, qitjet me armët e këmbësorisë me ngarkesa fizike, e shumë tema të tjera të programit, kanë rritur performancën e këtij kursi. Këtij kursi po i nënshtrohen edhe tre oficerë të batalionit komando si: toger Elson Feti, nëntoger Krenar Xhaferri dhe nëntoger Ernest Sulejmani. Toger Feti, shprehet se: “programi që zhvillohet është bazuar në eksperiencën që ka batalioni komando dhe eksperiencat perëndimore të ushtrive analoge, sidomos asaj turke. Si komandant toge që jam, këtë eksperiencë të fituar do ta aplikoj edhe me efektivin që drejtoj dhe mendoj se kursi komando, do të na shërbejë të gjithëve, për të reflektuar dhe për të përmirësuar punën në të ardhmen...”





Në pritje për fillimin e kursit të 9-të, të Forcave Speciale

# Forcat Speciale, interesi në rritje tregon rritjen e profesionalizmit

**G**arnizoni i Zall Herrit gjithmonë ka pasur veçantinë e shumë risive. Tradita e krijuar me ndërthurjen e ekzistuese me eksperiencat e ushtrive të huaja ka krijuar një standard në rritje, i cili starton edhe një herë sfidën e radhës siç është fillimi i kursit të nëntë. Padurimi i shumë ushtarakëve të cilët duan të jenë pjesë e kësaj force elitare duke u përqsasur me kërkesat dhe ndërthurur me nevojat e krijuara nga reformimi i Forcave të Armatosur në përgjithësi, si dhe ristrukturimi i Forcave Speciale në veçanti krijuan terrenin e nevojshëm për nisjen e procedurave të fillimit të kursit të radhës në BFS.

Forcat Speciale kanë nevojë për një "gjak të ri" me qëllimin e mirë për të sjellë emocionet e reja të atyre ushtarakëve të përgatitur të Forcave të Armatosura, që këtë kurs e shohin si një tregues të rëndësishëm në karrierën e tyre ushtarake. Personeli i Forcave Speciale ka krijuar një eksperiencë e cila është vlerësuar në të gjitha angazhimet e marra brenda dhe jashtë vendit, duke mos i shpëtuar as vëmendjes së forcave aleate në misionet dhe detyrat e realizuar së bashku. Sfida sapo ka nisur. Dëshira për të ripërtërirë efektivitetin e Batalionit të Forcave Speciale, jo individuale, por e planëzuar është në rrugë të mbarë. Këtë vit një mundësi më shumë u ofrua për të gjithë ata që mendojnë se mund të kontribuojnë në këtë repart elitare, duke e marrë atë edhe si sfidë personale. Me daljen e urdhrave në lidhje me këtë proces u fillua një fushatë marketingu në të gjitha njësitë e Forcave të Armatosura për të nxitur tërheqjen e elementeve më të mirë të Forcave të Armatosura në një kurs i cili në vetvete është shumë më shumë se një sfidë. Ekipi i caktuar nga Forcat Speciale



mori kontakt me të gjitha repartet ku vlen për tu theksuar angazhimi i të gjithë komandantëve për të dhënë mundësinë e komunikimit me kandidatët e interesuar dhe nxitjen e më të mirëve për ta ndjekur këtë kurs. Kjo tregonte dhe një klimë dashamirësie ndaj nesh dhe vlerësim për të gjitha arrijtet ndër vite i të gjithë personelit dhe drejtuesve të Forcave Speciale. Përfitojmë nga rasti të përshëndes dhe t'ju uroj suksese kudo ku ata janë duke na bërë që të ndihemi të privilegjuar për vazhdimin e stafetës dhe të arrijmë tregues profesional edhe më të lartë në sfidat e radhës.

Elitat krijojnë tradita të cilat motivojnë brezat për arrijten e treguesve të veçantë individuale dhe institucionale dhe ne anëtarët e Forcave Speciale jemi krenar për përkatësinë dhe repartin

tonë. Si masë paraprake për fillimin e kursit të nëntë me përkujdesjen e stafit drejtues filloi procesi i përzgjedhjes së stafit i cili do të merret me mbarëvajtjen e këtij kursi. Nëpërmjet marketingut publikim të njoftimit në gazetën "ushtria" të njoftimit për hapjen e kursit dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për të vazhduar këtë kurs, mundësi e ofruar për të gjithë ushtarakët në FA, u synua që si tregues i përzgjedhjes të jetë profesionalizmi dhe vullnetarizmi. Më datë 3 shkurt 2014, pas 2 javëve reklamimi u arrit të arrihej numri i kandidateve 171, u tregua kujdes që ti jepej mundësia çdo njeriu i cili kishte dëshirë të konkurronte për të qenë pjesë e Forcave Speciale ose thjeshtë për të mbaruar kursin e Forcave Speciale për të bërë ndryshimin me kolegët e

tyre. Jam i mendimit se individualiteti pavarësisht anëve negative në formimin e kolektivitetit ka dhe anën pozitive që nxit konkurrencën dhe stimulon suksesin. Pasi në fund të gjithë duam të jemi më të mirët dhe që të jesh më i miri kurse të tilla të japin mundësinë të konkurros dhe sfidosh të tjerët. Pas regjistrimit të kandidatëve u zhvilluan testimet në disiplinat: vrapim 3,2 km, pompa mbi duar, palosje dhe tërheqje në hekur, vrapim 7,2 km me pajime (25 kg), testimi i gjuhës angleze; hedhje granatash dhe zvarritje 400 m; vrapim 27 km; testim në qitje; test intelektual; not 100 m, si dhe një intervistë ku komisioni vlerësonte formimin e përgjithshëm dhe psikologjik të kandidatëve. Vlen të theksohet që përkushtimi i kandidatëve ishte në nivelin më të lartë dhe kjo rriste optimizmin e komisionit për cilësinë e kandidatëve që do mund të futeshin në kurs. Nga 171 kandidatët të regjistruar u paraqitën 123 kandidatë. U tërhoqën nga gara 11 kandidatë, u eliminuan 31 dhe ju dha mundësia për të qenë pjesë e kursit të 9-të, të Forcave Speciale 81 kandidatëve. Ky kurs zhvillohet bazuar në rregulla të forta dhe përzgjedhëse. Kandidatët mund të tërhiqen në çdo kohë duke plotësuar një kërkesë me shkrim. Kursi në veçantë të tij është i barabartë dhe i hapur për oficerë, nën-oficerë dhe ushtarë profesionist. Gjatë kursit kandidatët s'kanë asnjë të drejtë duke u zhveshur nga gradat, detyrat e mëparshme duke qenë të barabartë para rregullave. Rezultati përcaktohet nga vetë kandidati mbi bazën e meritokracisë. Në 6 muaj kandidatët do të kalojnë nga një program tejet i ngjeshur me ngarkesë fizike psikologjike si dhe njohurive taktike individuale, në grup dhe speciale. Për herë të parë në këtë kurs do të futet vlerësimi i kolegëve i

njohur ndryshe si "peers sevaluation", do të futen stërvitjet e pandërprera mbi 72 orë, ku në raste të veçanta kandidatët do të privohen nga gjumi dhe ushqimi normal. Përmes këtyre skenarëve do të arrihet sfidimi i mundësive individuale i të gjithë kandidatëve për t'i çuar ata të përballojnë ngarkesat fizike, mendore dhe psikologjike. Objektivi është që kandidatët që do kenë shansin për t'u diplomuar të kenë aftësi organizative dhe planëzuese shumë të mira edhe nën kushte të lodhjes ekstreme, të stresit, kushteve të vështira, atmosferike e të terrenit, të arrijnë të drejtojnë me aftësi lidhshipi të larta vartësit dhe të jenë të aftë të marrin vendime të sakta, të fitojnë zemrën e kolegëve, duke u bërë lojtarë të mirë në grup. Në aspektin fizik të arrijnë mbi 100 pompa, palosje; 20 tërheqje në hekur; 27 km 3 orë me pajime, të njohë parimet bazë të zhytjes dhe të arrijnë të zhytet në 7 m thellësi dhe 25 metra gjatë nën ujë, të notojnë 5 km distancë; të njohë shumë mirë lidhjet e ndryshme, parimet bazë alpine në ngjitje, zbritje dhe praktikimin me sukses të tyre. Një tjetër disiplinë me të cilën do përballen kandidatët është edhe qitja, kandidati për këtë të arrijnë notën maksimale në çdo qitje duke dërguar të gjitha goditjet në tabelë me grumbullim mbi 85 % të pikëve të mundshme, dhe të arrijnë treguesit e qitjes së besimit si i vetmi repart në të cilën praktikohet kjo qitje në vendin tonë dhe më gjerë. Kandidati gjithashtu duhet të arrijnë me sukses operacionet e njësisë të vogla, si goditje objekti, operacionet në godinë, në qendra të banuara, luftimin e afërt, zbulimin special operacione në prapavijë të kundërshtarit deri në 70 km thellësi, aftësimi i tyre në kryerjen e operacioneve në mungesën e ushqimit dhe kushteve ekstreme të terrenit, realizimi me sukses i traversës së zonës deri në 150 km brenda kohës së përcaktuar etj. Nëse të gjitha këto parametra arrihet në kohët e fundit të kursit konkludohet me hartimin e planëzimit nga kandidati dhe kryerjen e detyrave reale me imitues. Kursi do të zhvillohet nga oficerë dhe nën-oficerë me eksperiencë dhe kualifikime brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu është planifikuar që module të veçantë të zhvillohen nga oficerët më të mirë të Forcave të Armatosura dhe instruktorëve amerikanë dhe të vendeve të tjera aleate. Temat dhe programi është surprizë duke nxitur aftësinë reaguese dhe menaxhuese të kursantëve para gjërave të paplanifikuara. Batalioni i Forcave Speciale ka marrë të gjitha masat, duke krijuar një infrastrukture stërvitore e logjistike funksionale dhe me standarde, duke pritur fillimin e kursit të 9 të Forcave Speciale.

Major Shkëlqim Llagaci  
Komandanti i Kursit në BFS







## ANO, zhvillohet "Kursi i Instruktorit të Stërvitjes për Nënoficerë"

Akademia e Nënoficerëve "Thomson" në kuadër të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, nga data 25 në 28 mars 2014, priti dy instruktorë trajnues të saj për zhvillimin e një kursi katërditor, "Kursi i Instruktorit të Stërvitjes për Nënoficerë", me pjesëmarrjen e 12 instruktorëve të ANO-së dhe 14 instruktorëve të Shkollës së Trupës. Instruktorët e ekipit të lëvizshëm trajnues, MSG Jack Niemynski dhe SFC Larry Cascio, të mbështetur dhe në programin e kursit u përqendruan kryesisht në elementët kryesorë përbërës të zhvillimit të një ore mësimi. Disa nga këto elemente ishin: prezantimi i instruktorit të stërvitjes bazuar kjo sipas një strukture dhe metode të përcaktuar ku të gjithë instruktorët kishin mundësinë ta praktikonin një gjë të tillë; ndërtimi dhe plotësimi i planit mësimor nga instruktorët; zhvillimi i një ore mësimi nëpërmjet programeve të paketës MS Office; teknikat e komunikimit gjatë zhvillimit të orës së mësimi nëpërmjet volu-

mit e tonit të zërit, përdorimit të mimikës, gjesteve etj.; llojet dhe teknikat e formulimit dhe drejtimit të pyetjeve; plotësimi i formularit të vlerësimit të instruktorit në përfundim të mësimi si dhe zhvillimi i analizës pas veprimit, i analizës formale dhe joformale në përfundim të çdo ore mësimi. Ajo çka vlen të përmendet në këtë kurs ishte fakti se që në diskutimet e para me trajnuesit e Gardës Kombëtare të New Jersey-it u konstatua nga ana e tyre se niveli profesional i pjesëmarrësve në kurs ishte më i lartë se programi i zhvilluar në të, dhe se ndryshimet në mënyrën e shpjegimit të mësimi, komunikimit me kursantët, plotësimi të shkurtimorëve etj. ishin shumë të vogla. Në përfundim të kursit u konkludua se planet e bashkëpunimit dypalësh, sidomos në fushën e arsimimit dhe trajnimit të nënoficerëve duhet të jenë prioritet për vitin 2014 e më pas, për këtë u diskutua që në të ardhmen të zhvillohen vizita të ndërsjella me qëllim rritjen e eksperiencës në mësimdhënie.

Nëntogere Morena Halilaj

# Shkolla e Trupës Bunavi, shembull për bashkëpunim e trajnim ndër-institucional

*Përfundon kursi trajnues i personelit "Radarist" i "Njësisë së Lëvizshme Territoriale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë"*

Nënkolonela Alda Sula

Është zhvilluar para pak ditësh ceremonia e përfundimit të trajnimit nga SHT Bunavi, e personelit "Radarist" të "Njësisë së Lëvizshme Territoriale të Kufirit dhe Migracionit" (NJ.T.K&M), Vlorë. Qëllimi i këtij trajnimi në mjediset e kësaj njësie, ishte aftësimi i një grupi punonjësish të NJ.T.K&M, Radhimë Vlorë, me detyrat teorike dhe praktike në funksionet e "radaristëve" në motovedeta. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Agim Shahu, komandanti i NJ.T.K&M, komisar Rexhep Barjamaj, personeli i kësaj njësie si dhe personeli i seksionit detar të SHT. Drejtuesi i NJ.T.K&M Vlorë, komisar Rexhep Barjamaj, në cilësinë e organizatorit dhe vendit pritës, i uroi mirëseardhjen komandantit të SHT, kolonel Shahut, si dhe trupës pedagogjike të seksionit detar. Në fjalën e tij, ndër të tjera ai falënderoi personelin e SHT dhe në veçanti atë të seksionit detar për punën e bërë në trajnimin e kursantëve si dhe performancën e shkëlqyer të pedagogëve të këtij kursi. Të pranishmit në këtë ceremoni i përshëndeti dhe komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Agim Shahu, i cili vlerësoi në veçanti bashkëpunimin e shkëlqyer me komisar Barjamaj dhe stafin e tij. Kolonel Shahu, vlerësoi mirëkuptimin, mbështetjen e dhënë në të gjitha drejtimet, në krijimin e të gjitha mundësive për trupën pedagogjike mësimdhënëse, duke ndikuar pozitivisht në mbarëvajtjen e kursit. Më tej kolonel Shahu theksoi se: "Ku ka bashkëpunime të tilla, si ky me NJTK&M në Vlorë, ka edhe rezultate dhe ku ka rezultate ka edhe cilësi dhe performancë në realizimin e misionit kushtetues në çdo strukturë dhe institucion shtetëror dhe jo shtetëror. Nga ana tjetër një falënderim shkon dhe për përkushtimin e gjithë personelit të seksionit detar, pedagogëve të këtij kursi si dhe në veçanti shefin e seksionit detar nënkolonel Qerim Shkrepa për punën e bërë, bashkëpunimin e shkëlqyer me NJTK&M, angazhimin maksimal të tyre si dhe rezultatet e arritura në përfundim me sukses të këtij kursi". Pjesëmarrësit në ceremoni u njohën nga komisar Qani Shahaj dhe kapit. lejti Ilirjan Kristo me



ecurinë si dhe rezultatet e arritura nga kursantët në këtë kurs, për të gjithë periudhën afro njëmuajore të zhvillimit të tij. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për gjithë kursantët që përfunduan kursin, ku u listuan më të mirët, sipas parimit të List-Meritës: "Performancë-Rezultate". Drejtuesi i NJ.T.K&M Vlorë, komisar Rexhep Barjamaj i dha komandantit të SHT, kolonel Agim Shahut, "Certifikatën e Mirënjohjes". Trajnimi dhe certifikimi i personelit "Radarist" i NJ.T.K&M strukturë e MB, që shërbejnë në mjetet lundruese, nga ana e SHT Bunavi, është realizuar në kuadër të b/punimeve ndër-institucionale të filluara më herët. Periudha një muajore e zhvillimit të këtij kursi, bëri të mundur gërshetimin e teorisë dhe zgjidhjen e detyrave konkrete në det, duke synuar aftësimin sa më mirë në detyrat funksionale në monitorimin dhe zbatimin e ligjshmërisë në det, lidhur me institucionet të cilat kanë interesa në det, sipas marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, e cila ngarkon me përgjegjësi strukturat përkatëse për bashkëpunimin dhe trajnimin reciprok, siç është dhe rasti konkret i Njësisë së Lëvizshme Territoriale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë (NJ.T.K&M), strukturë në varësi të Ministrisë së Brendshme, si një nga strukturat speciale, e cila kryen detyra në det. Për

përgatitjen e programit u organizuan konsulta ndërmjet pedagogëve, instruktorëve të Seksionit të Arsimit Stërvitjes dhe Seksionit Detar të SHT, nën drejtimin e n/kolonel Qerim Shkrepa dhe shefit të Seksionit detar të njësisë së MB, komisar Qani Shahaj. Në nocionin e "detarit" funksioni i radaristit në motovedetë është bars me syrin dhe veshin e komandantit në një operacionin detar. Duke qenë një profesion i tillë, vëmendja e pedagogëve u përqendrua në arritjen e qëllimit final: Çdo kursant të arrijë në përfundim të kursit të bëhet "mjeshtër" në përdorimin e mjeteve teknike dhe elektronike të lundrimit që disponojnë motovedetat e MB. Me mbështetjen maksimale të komandantit të Njësisë së Lëvizshme Territoriale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë, sidomos me resurset logjistike të saj në dispozicion, u bënë të mundura daljet në det, zgjidhja e detyrave konkrete praktikave të domosdoshme lundimore në zonën e përgjegjësisë, si dhe shtrirja e bashkëpunimit ndër-institucional në shfrytëzimin dhe përdorimin e kapaciteteve të përbashkëta, për të realizuar procesin e trajnimit të kursantëve. Praktikën detare të zhvilluar nga SHT, në rajonin e derdhjes së Vjosës deri në Gjirin e Dhërmiut u fokusuan edhe në zbatimin konkret të mësimëve teorike duke u ndërrthurr me detyrat e misionin që ka kjo njësi speciale për ndalimin e

trafikimit të lëndëve narkotike dhe kontrabandës së mundshme në këtë hapësirë detare. Gjatë zhvillimit të procesit arsimor me kursantët, komisar Murat Murataj, me detyrë zv/komandant në njësinë e NJ.T.K&M, si oficer policie me përvojë të madhe, u kujdes çdo ditë për mbarëvajtjen e kursit dhe mbështetjen me bazë materiale e didaktike të pedagogëve të SHT. Falë punës këmbëngulëse nga pedagog kapiten lejtant Ilirjan Kristo dhe kapiten Rangu. II Msc Fatmir Kalem, personeli i SHT Bunavi, u bë e mundur që pas katër javësh trajnimi intensiv, kursantët të lundrojnë në mënyrë të pa varur dhe të zgjidhin detyrat shumë mirë duke u certifikuar si "Radarist". Aktualisht, në SHT vijnë me sukses kurset institucionale si: "Kursi Bazë i Oficerit" (KBO), "Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë" (SIB) si dhe ai i "Stërvitjes Individuale të Avancuar" (SIA). I gjithë personeli i Shkollës së Trupës është i angazhuar në maksimum për vijimin dhe përfundimin me sukses të këtyre kurseve si dhe për pritjen, akomodimin dhe zhvillimin e kurseve të tjera institucionale për Oficerët dhe nënoficerët me fokus të veçantë për këtë vit stërvitor e arsimor, tek cilësia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies së pedagogëve dhe instruktorëve të SHT, sipas Planit të Trajnimit dhe Arsimit të FARSH dhe synimeve ambicioze të snajper vitin 2014.

## SHKURT

### Anija e Rojës Bregdetare P-03 në operacion për zbatimin e ligjshmërisë detare

Më datën 28 mars 2014, në zbatim të urdhrimit të komandantit të FD, anija e Rojës Bregdetare P-03, me komandant, kap. lt. Mario Miftari, zhvilloi një operacion për ndalimin dhe kryerjen e bordimit të anijes tregtare "Prometeu". Anija "Prometeu" me flamar Filipinas vinte nga porti Bile i Malit të Zi dhe po lundronte në jug. Ndërkohë kapiteni i saj duke lundruar në gjirin e Vlorës nuk i ishte bindur urdhrimit të Kapitenerisë së Portit Vlorë dhe Policisë sonë Kufitare për kontroll dhe bordim. Në këto kushte ju kërkua ndihmë anijeve tona të Rojës Bregdetare për bashkëpunim në këtë operacion. Me daljen në det të anijes sonë P-03, anija "Prometeu" ju nënshtrua zbatimit të ligjit. Kështu personeli nga Roja jonë Bregdetare, Policia Kufitare dhe Guardia Financa bënë bordimin dhe kontrollin e anijes së huaj tregtare sipas rregullave dhe ligjeve detare. Mbase këtij kontrolli anija "Prometeu" u lejua të vazhdonte lundrimin në kursin e përcaktuar, ndërsa P-03 u kthye në vend-bazimin e Pashalimanit në pritje të operacionit të radhës.

Kap.Lt. Leonard Bidaj

### Zhvillohet stërvitja "Ferraj 2014"

Në zbatim të "Planit të Aktivitetëve Kryesorë Stërvitore" të BrMR-së për vitin 2014, si dhe në zbatim të urdhrimit të komandantit të BrMR-së, Nr. 91, datë 20.03.2014 në datat 26-27 mars, u zhvillua stërvitja fushore "Ferraj 2014", me efektivin e kompanisë së mbështetjes së përgjithshme të batalionit të Xhenios, në rajonin BrMR-Ferraj. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive operacionale të kompanisë së mbështetjes së përgjithshme të batalionit xhenier, për organizimin dhe kompaktësimin e veprimeve të kompanisë gjatë kryerjes së punimeve fortifikuese, në ruajtjen dhe mbrojtjen e një vend komande shtabi. Shtabi i batalionit të Xhenios kishte marrë masa për zhvillimin e kësaj stërvitjeje. Kjo stërvitje u ndoq nga afër nga shtabi i Brigadës së Mbështetjes Rajonale. Gjatë stërvitjes efektivet e tre togave të drejtuar me profesionalizëm nga komandantët e tyre zhvilluan veprime praktike për hapjen e pozicioneve të zjarrit dhe zënien e tyre, mënyrat e fortifikimit dhe maskimit të tyre si dhe demonstruan të gjithë elementet e shërbimeve për kompaktësimin e veprimeve praktike të Kompanisë së Mbështetjes së Përgjithshme. Në përfundim të stërvitjes, përfaqësuesit e Shtabit të Brigadës, falënderuan efektivin dhe drejtuesit e stërvitjes për performancën e treguar.

Mimoza Metko



# Në këtë 5 vjetor të anëtarësimit në NATO...

**N**derim dhe respekt për popullin shqiptar, që pavarësisht diktaturës së egër shumëvjeçare e ruajti në shpirt dhe mendje dëshirën për tu anëtarësuar në Aleancën veri-atlantike, si Aleanca më e suksesshme në historinë botërore, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në periudha të vështira të destabilitetit dhe pasigurisë në vende e rajone të ndryshme të botës. Për shqiptarët, paqja është e shenjtë dhe populli ynë e ka çmuar atë në shekuj. Ndaj populli ynë mbas viteve '90, në masën mbi 90%, më shumë se popujt e tjerë, e shihte dhe e sheh këtë aleancë si garantin e paqes në botë. Si rezultat i bindjes së popullit tonë në vlerat e aleancës, Shqipëria ishte nga vendet e para që u bë pjesë aktive e iniciativës së Partneritetit për Paqe (PfP), pavarësisht vështirësive ekonomike, resurseve të kufizuara dhe brishtësisë së institucioneve demokratike që po kalon dhe aktualisht, në këtë periudhë të stërzgatur tranzicioni. Më në fund Samiti i Bukureshtit i 2 Prillit 2009, përligji ëndrrën thaujse 50 vjeçare të popullit shqiptar, që tashmë është i ndërgjegjshëm për të fituar kohën e humbur në rrugën e tij të integritit në shoqërinë moderne, nëpërmjet përfshirjes e angazhimit në strukturat e sigurisë Euroatlantike. Nderim dhe respekt për marinarët tanë civilë dhe ushtarakë që me veprimet e bindjet e tyre, herë fshehurazi dhe herë haptazi, zgjuan ndërgjegjen e qytetarëve për të vërtetën e aleancës dhe rolin e saj në shërbim të paqes. Madje si marinarët e thjeshtë ashtu dhe drejtuesit e tyre mbas viteve '80, në masë të madhe i shikonin veprimet e diktaturës kundër aleancës si qesharake. Ndërsa kryenin detyrën të bindur verbërisht, në mentalitet e zemër admironin aleancën. Detarët tanë pavarësisht se i binin deteve dhe oqeanëve kryq e tërthor, nuk krijuan asnjë incident me anijet e NATO-s e Flotave të SHBA kudo në botë. Nderim dhe respekt për të gjithë ish të burgosurit e të persektuarit politikë, që pavarësisht kalvarit e vuajtjeve pafund në birucat e diktaturës, mbajtën gjallë ëndrrën se dikur Shqipëria do jetë pjesë e Aleancës. Nderim dhe respekt për shqiptarët e diasporës që me përpjekje të shumëlojshme përkrahën anëtarësimin e vendit tonë në NATO, madje shumë prej tyre kanë qenë ushtarakë të aleancës që në krijimin e saj, por si shtetas të tjerë. Nderim dhe respekt për omeraxhatorët e porteve tona që me dashamirësi priten bandolat e lidhën cimat e anijeve të NATO-s, duke lehtësuar e siguruar bregëzimin e tyre në portet tona. Nderim dhe respekt për kuadrot tanë detarë, të cilët më 4 dhjetor 1992, nënshkruan për herë të parë marrëveshjen e bashkëpunimit me NATO-n, për embargon ndaj ish-Jugosllavisë, dokumenti i parë historik i bashkëpunimit me aleancën, pavarësisht se ne nuk ishim vend anëtar. Nderim dhe respekt për ekuipazhet e dy çifteve Katër Silurues (KS) dhe tre kuadrateve të marinarëve, që në pranverën e vitit 1993, priten bujarisht e me ceremonial të përsosur ushtarak, Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Shkëlqesinë e Tij, z. Manfred Verner dhe komandantin e NATO-s, gjeneralin me 4 yje, Vinsent. Nderim dhe respekt



për të gjithë ushtarakët shqiptarë, marinarë, gjitharmësh dhe ajrorë, që morën pjesë në stërvitjen e parë të përbashkët paqeruajtëse SAR-EX-01, me marinsat e Flotës e SHBA-së, që shënon dhe ballafaqimin e parë miqësor ushtarak me ushtarakët e NATO-s, mbas gjysmë shekulli Luftë të Ftohtë. Nderim dhe respekt për të gjithë qytetarët shqiptarë, nga Durrësi në Vlorë, nga Saranda në Shëngjin, nga Kavaja në Shkodër e Tiranë, gjithandej, Jug-Veri, Lindje-Perëndim, që në fillim vitet '90, u ngritën mbi konservatorizmin e kohës dhe bujarisht zbatuan traditën e sofrës e besës shqiptare për mikun e parë, që në këto raste ishin ushtarakët e NATO-s. Nderim dhe respekt për Forcat tona të Armatosura, që në këto vite kanë qenë pjesë përbërëse e operacioneve dhe

aktivitetëve kryesorë të NATO-s, madje duke dhënë dhe dëshmorët e parë, si kapiten Feti Vogli, një hero i përbashkët i popullit shqiptar dhe i Aleancës. Ndërkohë pjesëmarrja e FA Shqiptare në veprimtaritë e Aleancës Atlantike dhe vendet partnere të saj është një përvojë e shkëlqyer dhe tepër e dobishme, që tregon se ne ndajmë vlera të përbashkëta me NATO-n, njëkohësisht jemi në gjendje që këto vlera t'i vëmë në funksion të paqes e sigurisë. Nderim dhe respekt për të gjithë ushtarakët e liruar dhe në pension, që me dhimbje, maturi e pjekuri përkrahën proceset demokratike në vend, si dhe reformat e ndërmarra në kuadrin e reformimit e transformimit të FA. Nderim dhe respekt për korpusin e rinj të ushtarakëve shqiptarë që me përkushtim

e profesionalizëm po punon për të realizuar standardet e kërkuara nga aleanca për FA shqiptare. Nderim dhe respekt për të gjithë ushtarakët shqiptarë që në këtë moment janë pjesë e misionëve të përbashkëta me aleancën, duke lartësuar emrin, flamurin, nderin dhe krenarinë e vendit të shqiptonjave. Nderim dhe respekt për popujt e vendeve të aleancës që me mjete politike, ekonomike, diplomatike dhe ushtarake, ndihmuan për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të Kosovës në veçanti dhe asaj shqiptare në përgjithësi, duke i dhënë frymëmarrjen e munguar në shekuj kombit shqiptar. Nderim dhe respekt për popullin amerikan, për ushtrinë amerikane, me të cilët miqësia dhe bashkëpunimi shekullor ka qenë tepër

domethënës dhe i dobishëm, sepse ka reflektuar paqë, begati, siguri dhe stabilitet për kombin shqiptar, ashtu siç ëndëronin rilindësit tanë. Gati 60 vjet më vonë mbas Evropës, SHBA i dhuruan kombit shqiptar një plan Marshall tepër të veçantë, që po e ndihmon atë të kapërcejë me sukses sfidat gjeopolitike të mijëvjeçarit të ri, në kohë dhe hapësirë. Prania e SHBA-së në rajonin tonë është pjesë e pandarë e procesit të sigurisë dhe i shërben paqes e stabilitetit në rajon e Evropë. Ndaj ne shqiptarët, për këtë, duhet t'i jemi mirënjohës popullit amerikan në jetë të jetëve. Nderim dhe respekt për të gjithë gazetarët tanë, të cilët gjatë këtyre viteve, me vërtetësi e realizëm, kanë përcjellë aktivitetet e përbashkëta të FA e shtetit shqiptar me vendet e Aleancës. Së fundmi, nderim dhe respekt për të gjithë shqiptarët që e festuan dy prillin, 5 vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, së bashku, pa paragjykimet shumëvjeçare që na kanë shkaktuar humbje brezash.

Shefqet Kërçelli

## PERFORMANCË E INSTRUMENTISTËVE TË OFFA NË DURRËS Pranvera në Durrës, nën tingujt e OFFA-së

**N**ë vazhden e Stinës Koncertore të Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura dhe të Programit artistik vjetor të këtij institucioni, ishte dhe koncerti recital i dy formacioneve të muzikës së dhomës të OFFA-së në Hollin Koncertor të Teatrit A. Moisiu në qytetin e Durrësit në datën 1 prill 2014. Tashmë jo vetëm publiku i kryeqytetit, por dhe ai i qyteteve të tjera po bën realitet ëndrrën e ndjekjes nga afër dhe të drejtpërdrejtë të muzikës më dinjitoze të artit klasik, bashkëkohor e modern (ku bën pjesë dhe repertori shqiptar) të ofruar nga këto formacione muzikore profesioniste me instrumentistët me të mirë të Orkestrës Frymore të FA-së. Koncerti u ndoq nga një publik i gjerë dhe nën duartrokitjet e tejjzgatura që mbuluan thaujse çdo pjesë të reper-

torit që me meritë artistët instrumentistë të OFFA-së ditën të shpalosin me vlerat dhe aftësitë e tyre me të mira individuale në një lojë mjeshtërore në kolektivitetin dhe lartësinë e dëshiruar duke fituar zemrat dhe duartrokitjet e publikut. Formacioni i kuartetit të klarinetave që ishte i përbërë nga Instrumentistët Mirel Burgia, Petrika Backa, Erind Mesiti, Xhevahir Hysi, shpalosën një gamë të gjerë të repertorit më të zgjedhur të muzikës botërore që nga veprat klasike e deri te ato me moderne që i dhanë një larmi imazhit dhe lojës (si instrumenti me virtuoze e solistik i orkestrës.) Një lojë virtuoze, vlerash interpretative në veglën e klarinetës ishte si një rezultat i një pune disa javore që ky kuartet ka nisur në kuadrin e përfaqësimit sa me dinjitoz të instrumentistëve më të mirë të OFFA. Këto koncerte pavarësisht që quhen Recitale, japin mesazhin

për afrimin e publikut të gjerë me punën që bëjnë artistët në Forcat e Armatosura, gjithashtu mbulohet jeta artistike e qyteteve si një mendësi e re në komunikim kulturor. Formacioni i saksave vinte në këtë koncert të dytë recital (para rreth një muaji ky formacion dha në hollin e T.O.B së bashku me formacionin e Harqeve një koncert tjetër të suksesshëm) me një repertor miks nga muzika shqiptare dhe ajo Botërore. Me shumë interes u priten nga publiku i qytetit të Durrësit kolazhi me këngë qytetare Shkodrane apo kolazhi i pjesëve Arbëreshe. Por loja mjeshtërore e tyre doli më në pah te pjesët e Jazzit dhe ato me bashkëkohore si: "Un Americano a Parigi", "Jerico" apo dhe kolazhi me tema të kompozitorit të madh E.Morriconne. (E kush nuk i njeh këto tema të filmave Western të Hollivudit!). Në përfundim

gjatë një kokeji të dhënë me këtë rast nga të pranishmit mikpritës, artistët të qytetit bregdetar të Durrësit u shprehën që dëshirojnë fillimin e një bashkëpunimi me institucione të kulturës me artistët dhe formacionet e vogla të dhomës të OFFA-së në të ardhmen. Gjatë diskutimit me dirigjentin e Orkestrës Frymore të qytetit të Durrësit u la i hapur dhe një koncert i përbashkët për hapjen e sezonit turistik veror. Tashme përveç orkestrës së plotë, instrumentistët e OFFA-së numërojnë disa formacione të vogla të muzikës së dhomës, atë të muzikës së lehtë si dhe Big-Band Swing-orkestra me një repertor të pasur të larmishëm e të konsoliduar.

Arben MUCA  
Udhëheqës Artistik i OFFA



# Mësim nga historia për lidhjet me aleatë

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ  
HISTORIAN USHTARAK

Jehona e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë i kaloi kufijtë e vendit. Shumë vende të Evropës filluan të shkruanin në shtyp dhe të flasin për luftën, si dhe të bënin propagandë. Aleatët e Mëdhenj e njohën më 17 dhjetor 1942 luftën e popullit tonë, si dhe jo vetëm që bënë vlerësime, por hynë dhe në lidhje me udhëheqjen ushtarake të tij. Marrëdhëniet u vendosën mbi baza organizative nëpërmjet përfaqësuesve ushtarakë të vendosur pranë komandave ushtarake të vendit, si me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të Ballit Kombëtar, të Legalitetit, si dhe të formacioneve të tjera që vepronin në atë kohë në vend. Kështu filloi ndërtimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve me misionet aleate, konkretisht me ushtarakët britanikë. Në fillimet e Luftës së Dytë Botërore, politika e Mbretërisë së Britanisë të Madhe ndaj Shqipërisë u shfaq me dy fytyra, qëndrim i ftohtë me rezerva dhe qëndrim i moderuar dhe miqësor, përfaqësuar konkretisht nga Ministria e Jashtme (Foreign Office) e SO2 (Organizatë për kryerjen e operacioneve). Diplomatat anglezë mendonin se Shqipëria nuk mund të ecte me këmbët e saj. Të tjerë e quanin “një faktor të dorës së dytë”. Vëmendja e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë erdhi duke u rritur në verën e vitit 1943. Në qershor 1943 u duk një mision ushtarak anglez në Jug të Shqipërisë, ku u takuan me Bedri Spahiun, udhëheqësin kryesor të PKSH-së në qarkun e Gjirokastrës. Ndërsa partizanët kishin më shumë arsye për të qenë dyshues, se sa Balli Kombëtar, ndaj ish-in ata të parët që e kuptuan rëndësinë e këtij kontakti dhe i pranuan britanikët. Pranë Shtabit të Përgjithshëm gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kanë vepruar tre misione britanike: misioni “Konsensus 2” i drejtuar nga Maklini; misioni i Kuartierit i drejtuar nga gjenerali Dejvis, që ishte edhe misioni më i madh britanik në Shqipëri dhe gjatë periudhës së fundit të luftës misioni i drejtuar nga koloneli Palmer. Në Zonën e Parë Operative (ZIOp) pranë Shtabit të tij ka vepruar misioni “Skulptori”. Telman thotë se “shtabi ynë ishte caktuar në një fshat të vogël të quajtur Sheper, mes maleve të Zagorisë”. Arritëm në Sheper, ku Telamni kishte komandën e tij, thekson një oficer tjetër anglez. Ai ishte rregulluar për bukuri dhe na priti me gjithë të mirat, por na tregoi se marrëdhëniet e tij me partizanët linin shumë për të dëshiruar. Komanda e ZIOp sipas udhëzimeve të Shtabit të Përgjithshëm, nuk e lejonte misionin britanik të njihet me planet e luftimit, sikurse nuk lejonte partizanët t’i shoqëronin në veprime luftarake. Porosia ishte se “anglezët në asnjë mënyrë mos i qasni të fusin hundët në punët tona...”. Ndaj kërkohet që karshi tyre “...të mbahej një konspiracion i plotë. Ata, s’duhet në asnjë mënyrë të dinë numrin e ushtarëve tanë”. Kështu misionarët britanikë u bënë thjesht oficerë furnizimi, apo edhe për t’i in- struktuar në përdorimin e armatimit që dërgonin apo të minave e eksplozivave. Ndaj në tërësi u shmang konsultimi, ndërsa në disa raste të pakta pati koordinim veprimtarie konkrete luftarake. Në verën dhe vjeshtën e vitit 1944 u ndërmorën pak operacione të kombinuara të karakterit të thjesht si detar, siç

*Refleksione me rastin e 70 vjetorit të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore*



Bill Tilman me parizanët

ishte zbarkimi i një komando angleze në Spile të Himarës. Ndërsa në veprimtarinë për çlirimin e qytetit të Sarandës, u bë një bashkëveprim i studiuar ndërmjet forcave zbarkuese angleze dhe forcave partizane të Gr. 5P dhe Br. XII, XIV dhe XIX S. Kjo ndikoi që garnizoni gjerman në Korfuz të dorëzohet më 12 tetor 1944, pas tri ditë të çlirimit të Sarandës. Pak më gjerë për këto dy zbarkime të anglezëve. Zbarkimi i parë u krye nga trupat e Long Range Desert Group (LRDG), në Spile të Himarës dhe zbarkimi i dyti

u krye nga trupat e komandove në Sarandë. Por, krahas këtyre, u krye të paktën edhe një zbarkim tjetër me trupat e SBS (Special Boat Service). Komanda e Përgjithshme dhe ajo e ZIOp, duke qenë tepër të vëmendshme ndaj anglezëve, nuk kishin besim në veprimet e tyre luftarake dhe dyshonin në sinqeritetin e tyre. Vetë zbarkimet e vitit 1944 janë shumë më të ndërlikuar nga sa shkruhet rreth tyre aty-këtu në literaturën e derisotme Perëndimore. Zbarkimi i parë në Spile, i kryer nga trupat LRDG, duket ka qenë mirëfilli një veprim i përbashkët anglo-shqiptar për të asgjësuar garnizonin gjerman, e që doli me sukses me ndërhyrjen e forcave partizane. Garnizoni gjerman përbëhej prej 65 veta, të vendosur në pozicione tepër të fortifikuara, bunker, transe, pjesë të minuara dhe të rrethuar me tela me gjemba. Pikëmbështetja më të afërta gjermane ishin Saranda e Llogora, por lidhja tokësore midis tyre ishte jashtëzakonisht e vështirë, sepse përgjatë rrugës forcat partizane ishin aktive. Trupat britanike do të zbarkonin aty me luftanije nga deti një forcë prej 100 veta. Rreth Spilesë u vendosën në formë patkoi batalioni i 4-t i Br. XII S, forcat territoriale të Kurveleshit të Poshtëm dhe të krahinës së Himarës, që zunë prita të forta në grykat midis Himarës e Vunoit dhe Himarës e Borshit. Më 28 korrik, në mesnatë, pas një rrahje të fortë të pozicioneve gjermane me artileri nga luftanijet, trupat britanike zbarkuan në Spile. Por gjermanët i mbrojtën me këmbëngulje pozicionet

e tyre. Ndërhyri Br. XII S, e cila sulmoi, shpartalloi garnizonin gjerman, çliroi Himarën dhe liroi edhe robërit anglezë që zunë gjermanët. Komandoja angleze, nën presionin e gjermanëve, u hipi varkave e u largua për në vendin nga ishin nisur. Zbarkimi i dyti, që u krye në Sarandë, nga fundi i shtatorit, ishte shumë më i dyshimtë. Ajo çka dëshmojnë dokumentet ekzistuese vërtetojnë katërcipërisht dyshimet e Komandës së Përgjithshme dhe të ZIOp. Zbarkimi

i Sarandës për herë të parë ndeshet në arkivat në një telegram disi të shqetësuar që Forin Ofisi i dërgon Barit më 29 shtator 1944, i cili thotë: “Lutemi njoftoni në lidhje në se anglezët kanë zbarkuar në Shqipëri”. Po atë ditë, Bari kthente përgjigje: “Operacioni në fjalë filloi si një sulm i rregullt më 22 shtator... Synimi ishte t’i krijoheshin shqetësime armikut në zonën përreth Sarandës...”. Por, vijonte telegrami, meqenëse dukej sikur garnizoni gjerman në Korfuz mund të arrihej të izolohej, më 24 shtator anglezët dërguan përforcime në armë e forca, “...dhe plani është që të vazhdohet operacioni deri sa të shihet në dorë Saranda”. Më tej vazhonte. “...në qoftë se çdo gjë do të shkojë mirë, ne mund të jemi në gjendje të mbajmë një bazë të përhershme në tokën shqiptare, ashtu si edhe në Korfuz”. Në lidhje me misionin ushtarak pranë kësaj komande, faktori ushtarak shfaqti dhe tregoi vlera. Që në raportet e para, misionarët britanikë kanë theksuar: “nga sa e njoh unë LNÇ-in, ata janë plotësisht në gjendje të qeverisin Shqipërinë...”. Ndërsa Çerçilli, kryeministër, më 4 nëntor 1943 deklaronte: “Mijëra partizanë shqiptarë po luftojnë në malet e tyre për pavarësinë e vendit të vet... Oficerët britanikë të ndërlidhjes janë pranë këtyre partizanëve dhe i kanë çmuar cilësitë e tyre luftarake. Ne shohim që shqiptarët po luajnë rolin e vet në përputhje me traditat e tyre të vjetra luftarake. Drejtimi më kryesor mund të themi se ngeli bashkëveprimi i Komandës së ZIOp me misionin ushtarak për dhënien e ndihmave materiale. Pas ardhjes së misionit të parë britanik, Shqipëria përfitoi nga planet për furnizim me anë të aviacionit, deri diku dhe nga


***Marrëdhëniet u vendosën mbi baza organizative nëpërmjet përfaqësuesve ushtarakë të vendosur pranë komandave ushtarake të vendit, si me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të Ballit Kombëtar, të Legalitetit, si dhe të formacioneve të tjera që vepronin në atë kohë në vend. Kështu filloi ndërtimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve me misionet aleate, konkretisht me ushtarakët britanikë.***



David Smiley (d) me parizanët



Foto nga arkivat britanike



21  
DAILAN and MAJ. WATROUS  
lunch at MIRAKE

deti. U krijuan disa baza hedhjeje, si në Sheper, Kurvelesh, Mali i Tragjasit, Karaburun, të cilat ishin një mbështetje për furnizimin e formacioneve partizane me armatim dhe veshmbathje, deri dhe të holla në sterlina. Sipas Reginald Hibert, Fildi në Jug bëri disa hedhje në Tragjas në shtator 1943, jo larg bregdetit në Jug të Vlorës; në shtator Tilmani bëri dy hedhje në Zagori, duke nisur kështu një proces të vazhdueshëm furnizimi me forcat partizane në një nga zonat e pakta të Shqipërisë, ku LNÇ-i kishte arritur përfundimisht mbizotërimin prej kohësh. Një dokument i përgatitur për Komitetin Operacional në Kajro për armët e hedhura në Shqipëri deri më 24 dhjetor 1943 thotë: Pushkë kundërtanke 150, mortaja 40, automatikë 300, pushkë gjysmë-automatike 400, pushkë 350, granata 4500, mina kundërtanke 1000 dhe eksploziv 6000 paund (rreth 3 tonë). Po kështu u raportua se u ishin dhënë grupeve guerile një shumë prej 4.823 florinj (deri në dhjetor 1943). Sipas autorit, pjesa më e madhe duhet t'u ketë shkuar partizanëve (armët dhe paratë). Në se partizanët morën furnizime, kjo ndodhi, sepse ata ishin aktivë. Është i pabazuar argumenti se ata u bënë aktiv qoftë kundër gjërma-

nëve, ose Ballit Kombëtar për shkak se morën furnizime. Sasitë e përfshira ishin tepër të vogla dhe kjo është e vërtetë. Ndihmesë misionet angleze kanë dhënë në mësimet e stërvitjet luftarake të disa batalioneve dhe grupeve partizane. Stërvitje janë bërë dhe për mësimin dhe përdorimin e armëve me të cilat po pajiseshin formacionet partizane, si automatikë, mitraloza 20 e 47 mm, mortaja 81 mm, si dhe për armët kundërtanke. Edhe grupe luftëtarësh në formacione janë stërvitur për përdorimin e minave në shkatërrimin e rrugëve, urave e të ndërtesave etj. Misionarët anglezë fillimisht nuk e kuptonin mirë natyrën e luftës partizane, strategjinë dhe taktikën e saj, ndaj në një memorandum të 3 janar 1943, theksonin se "për Shqipërinë parashikohej kur të piqeshin kushtet, dërgimi i forcave tokësore dhe detare aleate, si një pikë mbështetëse për veprime mësimore të forcave kryengritëse në këtë zonë". Me zhvillimin dhe përmasat që mori Lufta Nacionalçlirimtare, misionet angleze u bindën për efektivitetin e luftës partizane, për shkallën e lartë të organizimit, të disiplinës dhe të aftësive luftarake të luftëtarëve. BLO (oficerët britanikë të ndërlihdjes), me

partizanët e LNÇ-it e shihnin se vetëm klientët e tyre luftonin me gjermanin, në çfarëdo rruge, domethënë se ata e shihnin me sytë e tyre se këto ishin luftime gjithnjë e më serioze dhe jo të shtira. Për LNÇ-in, qëndrimi ndaj Ballit Kombëtar (i cili nuk angazhohej në luftë kundër pushtuesit) i misioneve angleze ishte dhe një faktor negativ, që ata të mbaheshin larg problemeve dhe planeve të luftës. Shtabi i ZIOp shikonte se misionet ushtarake angleze ishin tepër të interesuara dhe për ndihma ndaj organizatës së Ballit Kombëtar dhe të tjerëve që vepronin në atë kohë, si dhe problemi që ngrihej shpesh i luftës civile. Kështu në Dukat ishte vendosur një mision anglez, që rrinte pranë organizatës së Ballit Kombëtar. Vetëm pas 14 korrikut 1944, BBC mori direktivën të demaskonte Ballin Kombëtar si një organizatë kolaboracioniste. Problem doli nga korriku i 1944, se partizanët shqiptarë ndërhyjnë në qëllimet strategjike të anglezëve me anën e luftës civile. Përgjigjen e dha menjëherë Komandanti i Përgjithshëm ku theksonte: "Me goditjen e qendrave vitale dhe të komunikacionit të armikut në Jug, ne kemi bindjen se nuk pengojmë qëllimet e strategjisë aleate, por i ndihmojmë për së tepërmi dhe më së miri... e dimë mirë se pa ndihmën e aleatëve lëvizja jonë Nacionalçlirimtare nuk mund të ishte aq e fortë". Për këtë problem një tjetër anglez shprehet: "...ndërsa anglezët donin t'i shkatërronin rrugët e komunikacionit me qëllim që ato të mos përdroreshin nga Boshti, shtabet partizane argumentonin se po këto rrugë do t'i duheshin Shqipërisë nesër kur të çlirohej". Pas gushtit të vitit 1944, me arritjen e marrëveshjes midis Shtabit të Përgjithshëm dhe Shtabit Aleat të Mesdheut u rrit intensiteti i veprimtarisë luftarake, u rrit kuota me furnizimin mujor për ushtrinë. Ishte kjo një periudhe tepër e rëndësishme për përfundimin e luftës. Marrëdhëniet ushtarake në këtë periudhë u rritën, pranë Shtabit Aleat të Mesdheut u dërgua edhe përfaqësuesi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, komisari i ZIOp, Bedri Spahiu. Por, marrëdhëniet në aspektin politik karakterizoheshin nga kontradikta dhe mosbesim i ndërsjellë. Vlen të theksojmë se dhe Britania e Madhe ndaj Shqipërisë nuk pati një vijë të qartë. Politika e saj nuk depërtoi, pasi ishte e pasigurt, e pavendosur, duke përkrahur të gjitha rrymat e duke mos u pajtuar me asnjë. Por edhe nga fundi i luftës aleatët theksuan bashkëpunimin ushtarak me lëvizjen, në një kohë që në planin politik nuk shikohej asnjë veprim. Qëndrimi i anglezëve ishte aq konfuz, sa që më 19 korrik 1944, kur lufta kishte arritur kulmin e saj, Çerçilli i dërgonte Edenit një shënim me këtë kritikë të mprehtë: "Më thoni, ne me cilën palë jemi?". Populli i ZIOp e ka vlerësuar gjithnjë ndihmën e dhënë dhe punën që bënë misionarët gjatë luftës që qëndruan pranë tij. Duke ju hedhur një vështrim këtyre materialeve të kohës, si dhe misionit që forcat aleate kryen në atë periudhë të vështirë, bindesh në drejtësinë e forcave që luftonin për çlirim kombëtar dhe shoqëror. Tash pas 70 vjetësh, kupton dhe vlerëson si rëndësishme e bashkëpunimit, jo vetëm me forcat aleate, por dhe me forcat e tjera luftarake që vepronin në Shqipëri. Historia është gjykatësi më i mirë dhe i saktë i këtyre nismave dhe i veprimeve që u ndërmorën në ato vite lufte. Kujtimi i tyre të ndërgjegjësuar dhe të motivojë njerëzit për një qëllim fisnik të kohës, bashkëpunim dhe veprim konkret për të mirën e vendit.

## IN MEMORIAM



## Dinjitoz dhe ushtarak i formatuar për kohën...

## "In Memoriam" për pedagogun e AFA, Neritan Avdulaj

Këto ditë u nda nga jeta krejt pa pritur nënkolonel Neritan Xhemil Avdulaj, pedagog në Akademinë e Forcave të Armatosura. Neritani lindi në një familje me tradita atdhetare më 18 maj 1973 në Cakran të Fierit. Pas përfundimit të shkollës tetë vjeçare në fshatin e lindjes, ai iu bashkua Forcave të Armatosura në vitin 1987, viti kur dhe filloi studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Më tej vijoi studimet në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" dhe në qershor të vitit 1994 u diplomua officer i FA. Fillloi kështu karrierën ushtarake për më shumë se dy dekada në radhët e FA. Në misionin e ushtarakut, Neritani kreu detyra të ndryshme nga komandant toge, instruktor i përgatitjes speciale dhe specialist zbulimi në reparte e njësi të Forcave të Armatosura si në Delvinë, Përmet e Tiranë. Neritani ka marrë pjesë në dy misione ushtarake jashtë vendit. Kështu, ndërsa ishte duke kryer detyrën në Irak në vitin 2003, i vjen në jetë djali i parë, që në mënyrë simbolike e pagëzoi me emrin Irakli. Neritani ndoqi studimet akademike në vitet 2011-2012 në Akademinë e Mbrojtjes, ku mori mësimet në "Kursin e Komandës dhe të Shtabit të Përgjithshëm". Me përfundimin e këtyre studimeve të thelluara u emërua pedagog në akademi në departamentin e Lidershipit, ndërsa nga 1 shtatori 2013 u emërua si shef i "Grupit të Shkencave Ushtarake" në departamentin e Përgatitjes Ushtarake në Fakultetin e Arsimimit të Përgjithshëm të AFA-së. Detyrën e pedagogu në Akademi e ushtroi deri në fund të jetës së tij. Në të gjitha detyrat e misionet e ngarkuara, Neritani është karakterizuar nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë, e përkushtimit, e devotshmërisë, e integritetit në realizimin faqebardhë të tyre. Nga kolegët, akademistët dhe stafi akademik ai do të mbahet mend si njeri i dashur, i komunikueshëm, i ndjeshëm ndaj problemeve, i vëmendshëm ndaj të gjithëve. Ai dinte të ndërtonte marrëdhënie shumë të mira me vartësit, me kolegët dhe me eporët. Për këto marrëdhënie dhe vlera ai do të ngelet thellë në memorien e të gjithë atyre që e njohën në jetë. Neritani për përkushtimin në punën ka marrë medalje nga ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandanti i Forcës etj. Ai ishte nderuar me medaljonin "Për shërbime Ndërkombëtare", të "Karrierës", të "Shërbimit" etj. Neritani ndërtoi një familje të mrekullueshme, ku të dy bashkëshortët ishin në mësimdhënie dhe edukonin e mësonin dy djem. Ata të dy do ta ndjejnë mungesën e babait, mësuesit dhe edukatorit të tyre, por në mëndje dhe në zemër do të ruajnë vlerat dhe mesazhet që ai rrënjosi tek ata. Prindërit e tij, tashmë me boshllëkun që krijoi Neritani, do të dinë si të edukojnë nipërit e tyre, për të vazhduar më tej rrugën e lënë në mes nga ushtaraku i familjes. "Për vlerat e shfaqura në karrierën e tij ushtarake, që ishin shembull për të gjithë, - theksonte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në telegramin e ngushëllimit të familjarëve të Neritanit, - do të ngelet model dhe mësim për të gjithë oficerët e strukturave të FA." Një jetë të tërë Neritani ishte një njeri dinjitoz dhe ushtarak i formatuar për kohën. I tillë e dinjitoz ngeli deri në ditën e fundit të jetës, kur krejt papritur u nda nga jeta. Ai, dinjitoz u nda nga kolegët dhe miqtë e tij, e dinjitoz do të ngelet përjetë midis nesh. Ne ndahemi vetëm fizikisht me të, pasi ai do të jetë i pranishëm në auditorët e AFA, në Cakran të Fierit, por dhe në të gjithë Shqipërinë ku punoi e u përgatit si kuadro i denjë i FA. Ai u përcoll për në banesën e fundit me dhimbje, nga të gjithë ushtarakët e të njohurit e tij, por dhe nga ministrja e Mbrojtjes zj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral Jeronim Bazo, nga e gjithë bota akademike ushtarake. Fëmijët e tij kanë trashëgim një emër të madh, emrin e një njeriu dinjitoz, emër që duhet ta justifikojnë, duke nderuar në këtë mënyrë babanë e tyre model dhe shembull në të gjitha drejtimet. Ne të gjithë, do të themi me krenari se kemi punuar me Neritanin, kemi fituar nga përvoja e tij e rregullsisë e tij në punë dhe në shoqëri. I pa harruar kujtimi yt, Neritan!

Merita Alimuçaj

Foto nga arkivat britanike



8  
BISHOP, WATROUS in ZOG'S PALACE TIRANA





# NATO feston politikat e zgjerimit



## STATEMENT BY THE NORTH ATLANTIC COUNCIL CELEBRATING THE ENLARGEMENT ANNIVERSARIES

The North Atlantic Council today celebrates the anniversaries of the latest three rounds of NATO enlargement: the fifteenth anniversary of the accession of the Czech Republic, Hungary and Poland; the tenth anniversary of the accession of Bulgaria, Estonia, Latvia, Lithuania, Romania, Slovakia and Slovenia; and the fifth anniversary of the accession of Albania and Croatia.

By choosing to join NATO, Allies have shown their commitment to freedom, security, and the values and principles which are the foundation of the Euro-Atlantic community. Through their accession and contributions, NATO has become stronger and more inclusive.

The Open Door policy under Article 10 of the Washington Treaty is one of the Alliance's great successes. Through this historic process of Euro-Atlantic integration, peace, cooperation, and stability in Europe have been strengthened and democracy and the rule of law have been firmly anchored. Today we stand together in strong solidarity and in defence of our indivisible security and shared values, as envisaged in the Washington Treaty.

In celebrating these anniversaries we reaffirm that, in accordance with our policy, the Alliance's door remains open to new members in the future.

*Handwritten signatures of NATO Foreign Ministers*

Ditmir Bushati, Evgenios VENTZOS, Siwonhi, Anwarul Karim Khan, R. Chomands alubti, Jean Saint-Pierre, Purnan Adnan, Kim Hyeon-Gook, Edgar Rinnweis, J. Hinkrich, Ursula Paut, J. H., J. J. Kenny

NATO Foreign Ministers' meeting, Brussels, 1 April 2014



## Deklaratë nga Këshilli i Atlantikut të Veriut duke festuar jubiletë e zgjerimit

Këshilli i Atlantikut të Veriut feston sot jubiletë e tre raundeve më të fundit së zgjerimit të NATO-s: Pesëmbëdhjetë vjetorin e anëtarësimit të Republikës Çeke, Hungarisë dhe Polonisë; dhjetë vjetorin e anëtarësimit të Bullgarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë si dhe pesë vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë dhe Kroacisë.

Duke zgjedhur për t'u bashkuar me NATO-n, aleatët kanë treguar përkushtimin e tyre ndaj lirisë, sigurisë, vlerave dhe parimeve, të cilat janë themeli i bashkësisë euroatlantike. Nëpërmjet anëtarësimit e kontributit të tyre, NATO është bërë më e fortë dhe përfshirëse.

Politika e Dyerve të Hapura sipas nenit 10 të Traktatit të Uashingtonit, është një prej sukseseve më të mëdha të Aleancës. Nëpërmjet këtij procesi historik të integritimit euroatlantik, janë forcuar paqja, bashkëpunimi dhe stabiliteti në Europë dhe demokracia e sundimi i ligjit janë ankoruar në mënyrë të vendosur. Sot, ne qëndrojmë së bashku në solidaritet të fuqishëm dhe në mbrojtje të sigurisë sonë të pandashme e vlerave të përbashkëta, siç parashikohet në Traktatin e Uashingtonit.

Duke festuar këto jubile, ne riafirmojmë se, në përputhje me politikën tonë, dera e Aleancës mbetet e hapur për anëtarë të rinj në të ardhmen.

*Handwritten signatures of NATO Foreign Ministers*

Ditmir Bushati, Evgenios VENTZOS, Siwonhi, Anwarul Karim Khan, R. Chomands alubti, Jean Saint-Pierre, Purnan Adnan, Kim Hyeon-Gook, Edgar Rinnweis, J. Hinkrich, Ursula Paut, J. H., J. J. Kenny

NATO Foreign Ministers' meeting, Brussels, 1 April 2014